



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.33

26 mars

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 100 datë 26.3.2009	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Traktatin e Atlantikut të Veriut	1833
Ligj nr.10 101 datë 26.3.2009	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Marrëveshjen ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut për statusin e forcave të tyre”	1836
Ligj nr.10 102 datë 26.3.2009	Për ratifikimin e “Marrëveshjes për statusin e Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut, të përfaqësuesve kombëtarë dhe personelit ndërkombëtar”	1848
Ligj nr.10 103 datë 26.3.2009	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Marrëveshjen për statusin e misionëve dhe të përfaqësuesve të shteteve të treta në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut”	1855
Ligj nr.10 104 datë 26.3.2009	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Protokollin për statusin e shtabeve ushtarake ndërkombëtare, të ngritura në përputhje me Traktatin e Atlantikut të Veriut”	1857
Urdhër i MTKRS nr.92, datë 27.2.2009	Për licencimin e agjencive të administrimit kolektiv të të drejtave të prodhuesve shqiptarë të fonogrameve dhe videogrameve (AMI).	1862

LIGJ
Nr.10 100, datë 26.3.2009

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË TRAKTATIN
E ATLANTIKUT TË VERIUT

Në mbështetje të neneve 2 pika 3, 12 pika 3, 83 pika 1, 84 pika 4 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Traktatin e Atlantikut të Veriut, bërë në Uashington më 4 prill 1949.

Neni 2

Këshilli i Ministrave vendos për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si dhe për vendosjen apo kalimin në territorin shqiptar të forcave ushtarake të Aleancës në operacionet e vetëmbrojtjes kolektive, në kuadër të këtij traktati.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

TRAKTATI I ATLANTIKUT TË VERIUT

Uashington D.C.- 4 prill 1949

Palët në këtë traktat ripohojnë besimin e tyre në qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, si edhe në dëshirën e tyre për të jetuar në paqe me të gjithë popujt dhe qeveritë.

Ato janë të vendosura që të ruajnë lirinë, trashëgiminë e përbashkët dhe qytetërimin e popujve të tyre, të ngritura mbi themelet e parimeve të demokracisë, lirisë së individit dhe shtetit ligjor.

Ato kërkojnë të nxisin stabilitetin dhe mirëqenien në zonën e Atlantikut të Veriut.

Ato janë të vendosura që të bashkojnë përpjekjet e tyre për mbrojtjen e përbashkët dhe për ruajtjen e paqes dhe sigurisë. Ato si rrjedhim, bien dakord për këtë Traktat të Atlantikut të Veriut:

Neni 1

Palët marrin përsipër, siç parashikohet në Kartën e Kombeve të Bashkuara, që të zgjidhin çdo mosmarrëveshje ndërkombëtare në të cilën ato mund të përfshihen me mjete paqësore në një mënyrë të tillë që të mos vihet në rrezik paqja, siguria dhe drejtësia ndërkombëtare, si dhe të shmangen në marrëdhëniet e tyre ndërkombëtare nga kërcënimi apo përdorimi i forcës në çfarëdo mënyre që nuk është në përputhje me qëllimet e Kombeve të Bashkuara.

Neni 2

Palët do të kontribuojnë në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm të marrëdhënieve

ndërkombëtare paqësore dhe miqësore duke fuqizuar institucionet e tyre të lira, duke krijuar një mirëkuptim më të madh të parimeve mbi të cilat mbështeten këto institucione dhe duke i dhënë shtysë kushteve të stabilitetit dhe mirëqenies. Ato do të kërkojnë të zhdukin mosmarrëveshjet në politikat e tyre ekonomike ndërkombëtare dhe do të nxisin bashkëpunimin ekonomik ndërmjet cilitdo prej tyre apo ndërmjet të gjithave.

Neni 3

Me qëllim që të arrihen në mënyrë më të efektshme synimet e këtij traktati, Palët veç e veç dhe së bashku, përmes vetëndihmës dhe ndihmës së ndërsjelltë të vazhdueshme dhe të efektshme, do të ruajnë dhe zhvillojnë aftësinë e tyre individuale dhe kolektive për t'i bërë ballë sulmit të armatosur.

Neni 4

Palët do të këshillohen bashkërisht kurdoherë që, sipas mendimit të cilësdo prej tyre, kërcënohet integriteti territorial, pavarësia politike apo siguria e cilësdo prej Palëve.

Neni 5

Palët bien dakord se një sulm i armatosur kundër një apo më shumë prej tyre në Europë apo në Amerikën e Veriut do të quhet si sulm kundër të gjitha atyre dhe si pasojë bien dakord që, nëse ndodh një sulm i tillë, secila nga ato, në ushtrim të së drejtës së vetëmbrojtjes kolektive apo individuale të njohur nga neni 51 i Kartës së Kombeve të Bashkuara, do të ndihmojë palën apo palët e sulmuara në këtë mënyrë duke ndërmarrë menjëherë, individualisht dhe në bashkërendim me Palët e tjera, ato veprime që i vlerëson si të nevojshme, përfshirë këtu përdorimin e forcave të armatosura, për të rivendosur dhe ruajtur sigurinë në zonën e Atlantikut të Veriut.

Çfarëdo sulmi i tillë i armatosur dhe të gjitha masat e marra si rrjedhojë e tij do t'i njoftohen menjëherë Këshillit të Sigurimit. Masa të tilla do të përfundojnë kur Këshilli i Sigurimit të ketë marrë masat e nevojshme për të rivendosur dhe ruajtur paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.

Neni 6¹

Për qëllime të nenit 5, një sulm i armatosur mbi një apo më shumë palë vlerësohet se përfshin një sulm të armatosur:

-Mbi territorin e çdo pale në Europë apo Amerikën e Veriut, mbi Departamentet Algjeriane të Francës², mbi territorin e ose mbi ishujt nën juridiksionin e çdo pale në zonën e Atlantikut të Veriut në veri të Tropikut të Gaforres.

-Mbi forcat, mjetet lundruese apo ajrore të çdo pale, ku janë në apo mbi këto territore ose çfarëdo zone tjetër në Europë, në të cilën trupat pushtuese të cilësdo nga palët kanë qenë të vendosura në datën në të cilën Traktati hyri në fuqi ose Detin Mesdhe, ose zonën e Atlantikut të Veriut në veri të Tropikut të Gaforres.

Neni 7

Ky Traktat nuk prek dhe nuk do të interpretohet sikur prek në çfarëdo lloj mënyre të drejtat dhe detyrimet sipas Kartës, që kanë palët që janë anëtarë të Kombeve të Bashkuara, ose përgjegjësinë parësore të Këshillit të Sigurimit për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.

¹ Përkufizimi i territoreve për të cilat zbatohet neni 5 është rishikuar nga neni 2 i Protokollit ndaj Traktatit të Atlantikut të Veriut për hyrjen e Greqisë dhe Turqisë nënshkruar më 22 tetor 1951.

² Më 16 janar 1963, Këshilli i Atlantikut të Veriut vërejti se persa i përkiste ish departamenteve algjeriane të Francës dispozitat përkatëse të këtij Traktati ishin bërë të pazbatueshme që nga data 3 korrik 1962.

Neni 8

Secila nga palët deklaroi se asnjë nga zotimet ndërkombëtare tashmë në fuqi ndërmjet asaj dhe çdo pale tjetër apo cilitdo shtet të tretë nuk është në kundërshtim me dispozitat e këtij Traktati dhe merr përsipër të mos hyjë në çfarëdo zotimi ndërkombëtar në kundërshtim me këtë Traktat.

Neni 9

Palët caktojnë këtu një këshill, në të cilin do të përfaqësohet secila prej tyre, për të shqyrtuar çështjet në lidhje me zbatimin e këtij Traktati. Këshilli do të jetë i organizuar në një mënyrë të tillë që të jetë i aftë të mbledhet në çdo kohë. Këshilli do të ngrejë organe ndihmëse siç mund të jetë e nevojshme; në veçanti ai do të ngrejë menjëherë një komitet të mbrojtjes, i cili do të rekomandojë masa për zbatimin e neneve 3 dhe 5.

Neni 10

Palët, në marrëveshje të plotë, mund të ftojnë çdo shtet tjetër evropian në një pozitë të tillë të nxisë më tej parimet e këtij Traktati dhe të kontribuojë në sigurinë e zonës së Atlantikut të Veriut që të aderojë në këtë Traktat. Çdo shtet i ftuar në këtë mënyrë mund të bëhet palë në Traktat duke depozituar instrumentin e tij të aderimit pranë Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës do të informojë secilën nga palët për depozitim të çdo instrumenti të tillë aderimi.

Neni 11

Ky Traktat do të ratifikohet dhe dispozitat e tij do të zbatohen nga palët në përputhje me proceset e tyre përkatëse kushtetuese. Instrumentet e ratifikimit do të depozitohen sa më shpejt që të jetë e mundur pranë Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila do të njoftojë të gjithë nënshkruesit e tjerë për një depozitim të tillë. Traktati do të hyjë në fuqi ndërmjet shteteve që e kanë ratifikuar atë sapo ratifikimet e shumicës së nënshkruesve, duke përfshirë këtu ratifikimet e Belgjikës, Kanadasë, Francës, Luksemburgut, Holandës, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara të jenë depozituar dhe do të hyjë në fuqi në lidhje me shtetet e tjera në datën e depozitimit të ratifikimeve të tyre³.

Neni 12

Pasi Traktati të ketë qenë në fuqi për dhjetë vjet, ose në çdo kohë të mëvonshme, palët, nëse cilado nga ato kështu kërkon, do të këshillohen së bashku me qëllimin e rishikimit të Traktatit, duke patur parasysh faktorët që në atë kohë do të prekin paqen dhe sigurinë në zonën e Atlantikut të Veriut, duke përfshirë këtu zhvillimin e rregullimeve universale, si dhe rajonale sipas Kartës së Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.

Neni 13

Pasi Traktati të ketë qenë në fuqi për njëzet vjet, secila palë mund të pushojë së qeni palë një vit pasi njoftimi i denoncimit t'i jetë dhënë Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila do të informojë qeveritë e palëve të tjera për depozitim të çdo njoftimi të denoncimit.

Neni 14

³ Traktati hyri në fuqi më 24 gusht 1949 pas depozitimit të ratifikimeve të të gjitha shteteve nënshkruese.

Ky Traktat, tekstet e të cilit në anglisht dhe frëngjisht janë njëlloj autentikë, do të depozitohet në arkivat e qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kopje të vërtetuara siç duhet do t'i përcillen nga kjo Qeveri qeverive të nënshkruesve të tjerë.

LIGJ
Nr.10 101, datë 26.3.2009

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “MARRËVESHJEN NDËRMJET
PALËVE TË TRAKTATIT TË ATLANTIKUT TË VERIUT PËR STATUSIN E FORCAVE
TË TYRE”**

Në mbështetje të neneve 2 pika 3, 83 pika 1, 84 pika 4 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Marrëveshjen ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut për statusin e forcave të tyre”, bërë në Londër më 19 qershor 1951.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MARRËVESHJE
NDËRMJET PALËVE TË TRAKTATIT TË ATLANTIKUT TË VERIUT NË LIDHJE ME
STATUSIN E FORCAVE TË TYRE

Palët e Traktatit të Atlantikut të Veriut nënshkruan në Uashington, më 4 prill 1949;
duke marrë parasysh se forcat e një Pale mund të dërgohen, me marrëveshje, për të shërbyer në territorin e një Pale tjetër;

duke pasur në mendje se vendimi për t'i dërguar dhe kushtet në bazë të të cilave ato do të dërgohen, në shkallën që kushte të tilla nuk do të përcaktohen nga kjo Marrëveshje, do të vazhdojë t'i nënshtrohet marrëveshjeve të veçanta ndërmjet Palëve të interesuara.

duke dëshiruar, megjithatë, të përcaktojnë statusin e këtyre forcave ndërsa ndodhen në territorin e një Pale tjetër;
kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

1. Në këtë Marrëveshje shprehja:

a) “forcë” nënkupton personelin që i përket shërbimeve të armatosura tokësore, detare apo ajrore të një Pale Kontraktuese ndërsa ndodhet në territorin e një Pale tjetër Kontraktuese në zonën e Traktatit të Atlantikut të Veriut në lidhje me detyrat e tyre zyrtare, me kusht që të dyja Palët Kontraktuese të interesuara të mund të bien dakord që persona, njësi apo formacione të caktuara të mos konsiderohen sikur përbëjnë apo përfshihen në një “forcë” për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje;

b) “përbërës civilë” nënkupton personelin civil që shoqëron një forcë të një Pale Kontraktuese të cilët janë të punësuar në një shërbim të armatosur të asaj Pale Kontraktuese dhe që nuk janë persona pa kombësi, as shtetas të cilitdo Shtet që nuk është Palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe as shtetas apo banor i përhershëm i Shtetit në të cilin është vendosur forca.

c) “person në varësi” nënkupton bashkëshortin/en e një anëtari të një force apo të një përbërësi civil ose një fëmijë të një anëtari të tillë që është në varësi të tij apo të saj për mbështetje.

d) “Shtet dërgues” nënkupton Palën Kontraktuese së cilës i përket forca.

e) “Shtet pritës” nënkupton Palën Kontraktuese në territorin e së cilës është vendosur forca ose përbërësi civil, qoftë e vendosur atje, qoftë duke kaluar tranzit.

f) “autoritete ushtarake të Shtetit dërgues” nënkupton ato autoritete të një Shteti dërgues të cilët janë autorizuar nga ligji i tij të zbatojnë ligjet ushtarake të atij Shteti në lidhje me anëtarët apo përbërësit civilë të forcave të tij.

g) “Këshilli i Atlantikut të Veriut” nënkupton këshillin e krijuar nga Neni 9 i Traktatit të Atlantikut të Veriut ose cilindo nga organet e tij ndihmëse të autorizuar për të vepruar në emër të tij.

2. Kjo marrëveshje do të zbatohet ndaj autoriteteve të nënndarjeve politike të Palëve Kontraktuese kudo në territoret e tyre në të cilët Marrëveshja zbatohet apo shtrihet sipas Nenit XX, ashtu siç zbatohet në autoritetet qendrore të atyre Palëve Kontraktuese me kusht që, sidoqoftë, pasuria e zotëruar nga nënndarjet politike nuk do të konsiderohet si pasuri e zotëruar nga një Palë Kontraktuese brenda kuptimit të Nenit VIII.

Neni 2

Është detyra e një force dhe e përbërësit të saj civil dhe anëtarëve të tyre si dhe e personave në varësi të tyre që të zbatojnë ligjet e Shtetit pritës dhe t’i shmangen çdo veprimtarie që nuk është në pajtim me frymën e kësaj Marrëveshjeje dhe në veçanti çfarëdolloj veprimtarie politike në Shtetin pritës. Është gjithashtu detyrë e Shtetit dërgues për të marrë masat e nevojshme për këtë qëllim.

Neni 3

1. Sipas kushteve të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni dhe duke iu nënshtruar përputhjes me formalitetet e vendosura nga Shteti pritës në lidhje me hyrjen dhe daljen e një force apo të anëtarëve të saj, këta anëtarë do të përjashtohen nga rregullat për vizat dhe pasaportat dhe kontrollat e emigrimit kur janë duke hyrë apo duke dalë nga territori i Shtetit pritës. Ata do të përjashtohen gjithashtu nga rregullat e Shtetit pritës për regjistrimin dhe kontrollin e të huajve, por nuk do të konsiderohen se fitojnë ndonjë të drejtë për rezidencë apo banim të përhershëm në territoret e Shtetit pritës.

2. Vetëm dokumentet e mëposhtëm do të kërkohen në lidhje me anëtarët e një force. Ato do të paraqiten nëse kërkohet:

a) Karta e identitetit personal e lëshuar nga Shteti dërgues ku shënohen emrat, data e lindjes, grada dhe numri (në qoftë se ka ndonjë), shërbimi dhe fotografia;

b) Urdhër lëvizjeje kolektive apo individuale në gjuhën e Shtetit dërgues dhe në gjuhët anglisht e frëngjisht, lëshuar nga Agjencia e caktuar (e përshtatshme) e Shtetit dërgues ose e Organizatës së Atlantikut të Veriut dhe që vërteton statusin e individit apo grupit si një anëtar apo anëtarë të një force dhe të një urdhri për lëvizje. Shteti pritës mund të kërkojë që urdhri i lëvizjes të kundërfirmoset nga përfaqësuesi i tij i përshtatshëm.

3. Anëtarët e një përbërësi civil dhe personat në varësi të tyre do të përshkruhen si të tillë në pasaportat e tyre.

4. Në qoftë se një anëtar i një force apo i një përbërësi civil largohet nga puna e Shtetit dërgues dhe nuk riatdhesohet, autoritetet e Shtetit dërgues duhet të informojnë menjëherë autoritetet e Shtetit pritës, duke i dhënë të gjitha hollësitë e kërkuara. Autoritetet e Shtetit dërgues në mënyrë të ngjashme duhet të informojnë autoritetet e Shtetit pritës dhe për cilindo anëtar që mungon për më shumë se 21 ditë.

5. Në qoftë se Shteti pritës ka kërkuar largimin nga territori i tij të një anëtari të një force apo të një përbërësi civil apo ka nxjerrë urdhër dëbimi për ndonjë nga ish anëtarët e një force apo të një përbërësi civil ose ndonjë personi në varësi të një anëtari ose ish anëtari, autoritetet e Shtetit dërgues do të jenë përgjegjës për tërheqjen e personit në fjalë brenda territorit të tyre ose ndryshe ta largojnë atë jashtë Shtetit pritës. Ky paragraf do të zbatohet vetëm ndaj personave që nuk janë me kombësi të Shtetit pritës dhe që kanë hyrë në Shtetin pritës si anëtarë të një force, ose të një përbërësi civil ose me qëllim për t'u bërë anëtarë të tillë dhe ndaj personave në varësi të tyre.

Neni 4

Shteti pritës duhet ose:

a) të pranojë si të vlefshme pa testim ose pagesë lejen e drejtimit të automjetit ose liçencën apo lejen ushtarake të drejtimit të automjetit të lëshuar nga Shteti dërgues ose nënndarjet e tij të një anëtari të një force ose një përbërësi civil; ose

b) të lëshojë lejen e vet të drejtimit të automjetit ose liçencën ndaj çdo anëtari të një force ose përbërësi civil që zotëron një leje drejtimi të automjetit ose liçencë apo lejen ushtarake të drejtimit të automjetit të lëshuar nga Shteti dërgues ose nga një nënndarje e tij, me kusht që të mos kërkohej testim për drejtim automjeti.

Neni 5

1. Anëtarët e një force normalisht duhet të veshin uniformë. Duke iu nënshtruar ndonjë marrëveshjeje të kundërt ndërmjet autoriteteve të Shteteve dërguese dhe pritëse, veshja e rrobave civile duhet të kryhet me të njëjtat kushte si për anëtarët e forcave të Shtetit pritës. Njësitë ose formacionet e një force të krijuara rregullisht duhet të jenë me uniformë kur kalojnë një kufi.

2. Automjetet e shërbimit të një force ose përbërësi civil duhet të mbajnë përveç numrit të tyre të regjistrimit, një shenjë të dallueshme të kombësisë së tyre.

Neni 6

Anëtarët e një force mund të zotërojnë dhe të mbajnë armë me kusht që ata të jenë të autorizuar të veprojnë kështu nga urdhrat e tyre. Autoritetet e Shtetit dërgues do t'i shqyrtojnë me dashamirësi kërkesat nga Shteti pritës për sa i përket kësaj çështjeje.

Neni 7

1. Sipas dispozitave të këtij Neni,

a) Autoritetet ushtarake të Shtetit dërgues duhet të kenë të drejtë të ushtrojnë brenda Shtetit pritës të gjitha juridiksionet penale dhe disiplinore që i jep atyre ligji i Shtetit dërgues mbi të gjithë personat që i nënshtrohen ligjit ushtarak të atij Shteti.

b) Autoritetet e Shtetit pritës duhet të kenë të drejtë ligjore mbi anëtarët e një force ose përbërësi civil dhe vartësit e tyre në lidhje me shkeljet ligjore që kryhen brenda territorit të Shtetit pritës dhe të dënueshme nga ligji i atij Shteti.

2. a) Autoritetet ushtarake të Shtetit dërgues duhet të kenë të drejtën të ushtrojnë juridiksion ekskluziv mbi personat që i nënshtrohen ligjit ushtarak të atij Shteti në lidhje me shkeljet, duke përfshirë shkeljet që kanë lidhje me sigurinë e tij, të dënueshme nga ligji i Shtetit dërgues, por jo nga ligji i Shtetit pritës.

b) Autoritetet e Shtetit pritës do të kenë të drejtë të ushtrojnë juridiksion ekskluziv mbi anëtarët e një force ose përbërësi civil dhe personat në varësi të tyre në lidhje me shkeljet, duke përfshirë shkelje që kanë të bëjnë me sigurinë e atij Shteti, të dënueshme nga ligji i tij, por jo nga ligji i Shtetit dërgues.

c) Për qëllime të këtij paragrafi dhe të paragrafit 3 të këtij neni një shkelje në lidhje me sigurinë e një Shteti duhet të përfshijë:

- i) tradhti kundër Shtetit;
- ii) sabotazh, spiunazh ose dhunim të çfarëdo ligji lidhur me sekretet zyrtare të atij Shteti ose sekrete lidhur me mbrojtjen kombëtare të atij Shteti.

3. Në rastet kur e drejta për ushtrimin e juridiksionit është e njëkohshme, do të zbatohen rregullat e mëposhtme:

a) Autoritetet ushtarake të Shtetit dërgues do të kenë të drejtën parësore për të ushtruar juridiksion mbi një anëtar të një force ose të një përbërësi civil në lidhje me

i) Shkelje vetëm ndaj pronës ose sigurisë së atij Shteti ose shkelje vetëm ndaj personit ose pronës të një anëtari tjetër të forcës ose përbërësi civil të atij Shteti ose të një personi në varësi të tij;

ii) Shkelje që shkaktohen nga një veprim apo mosveprim i shkaktuar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare.

b) Në rastin e ndonjë shkeljeje tjetër, autoritetet e Shtetit pritës do të kenë të drejtën parësore për të ushtruar juridiksion.

c) Në qoftë se Shteti që ka të drejtën parësore vendos që të mos ushtrojë juridiksion, ai duhet të njoftojë autoritetet e Shtetit tjetër sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur. Autoritetet e Shtetit që kanë të drejtën parësore do t'i përgjigjen me dashamirësi kërkesës nga autoritetet e Shtetit tjetër për një përjashtim nga e drejta e tij në rastet kur Shteti tjetër mendon që një përjashtim i tillë të jetë i një rëndësie të veçantë.

4. Dispozitat e mësipërme të këtij neni nuk do të nënkuptojnë ndonjë të drejtë të autoriteteve ushtarake të Shtetit dërgues për të ushtruar juridiksion mbi personat të cilët janë Shtetas ose rezidentë të zakonshëm në Shtetin pritës, përveçse kur ata janë anëtarë të forcës të Shtetit dërgues.

5. a) Autoritetet e Shteteve pritës dhe dërgues do të mbështesin njëri tjetrin për arrestimin e anëtarëve të një force ose përbërësi civil ose personave në varësi të tyre në territorin e Shtetit pritës dhe në dorëzimin e tyre tek autoriteti i cili do të ushtrojë juridiksionin në bazë të dispozitave të mësipërme.

b) Autoritetet e Shtetit pritës do t'i njoftojnë në kohën e duhur autoritetet ushtarake të Shtetit dërgues për arrestimin e ndonjë anëtari të një force ose të një përbërësi civil ose personi në varësi.

c) E drejta e ndalimit të një anëtari të akuzuar të një force ose përbërësi civil mbi të cilin Shteti pritës duhet të ushtrojë juridiksion, në qoftë se ai është në duart e Shtetit dërgues, do të qëndrojë në atë Shtet derisa ai të akuzohet nga Shteti pritës.

6. a) Autoritetet e Shteteve pritëse dhe dërguese do të mbështesin njëri-tjetrin në kryerjen e të gjitha hetimeve të nevojshme ndaj shkeljeve dhe në mbledhjen dhe përpunimin e provave, duke përfshirë konfiskimin dhe në raste të përshtatshme, dorëzimin e objekteve që lidhen me një shkelje. Megjithatë, dorëzimi i objekteve të tilla mund t'i nënshtrohet kthimit të tyre brenda kohës së përcaktuar me hollësi nga autoriteti që i dorëzon ato.

b) Autoritetet e Palëve Kontraktuese do të njoftojnë njeri tjetrin mbi zgjidhjen e të gjitha rasteve në të cilat ka të drejta të njëkohshme për ushtrim të juridiksionit.

7. a) Një dënim me vdekje nuk do të zbatohet në Shtetin pritës nga autoritetet e Shtetit dërgues në qoftë se legjislacioni i Shtetit pritës nuk parashikon një dënim të tillë për një rast të ngjashëm.

b) Autoritetet e Shtetit pritës do ta gjykojnë me dashamirësi kërkesën nga autoritetet e Shtetit dërgues për mbështetje në zbatimin e një vendimi për burgim të shpallur nga autoritetet e Shtetit dërgues sipas dispozitave të këtij neni brenda territorit të Shtetit pritës.

8. Kur një i pandehur është gjykuar në përputhje me dispozitat e këtij neni nga autoritetet e një Pale Kontraktuese dhe është shpallur i pafajshëm ose është dënuar dhe po vuan ose ka vuajtur dënimin

e tij ose është falur, ai nuk mund të gjykohet përsëri për të njëjtën shkelje brenda të njëjtit territor nga autoritetet e Palës tjetër Kontraktuese. Megjithatë, asgjë në këtë paragraf nuk do të pengojë autoritetet ushtarake të Shtetit dërgues nga gjykimi i një anëtar i forcës së tij për çfarëdo dhunimi të rregullave të disiplinës që lindin nga një veprim apo mosveprim i cili përbënte një shkelje për të cilën ai është gjykuar nga autoritetet e një Pale tjetër Kontraktuese.

9. Kurdoherë që anëtar i një force ose përbërësi civil ose një person në varësi të tij është proceduar nën juridiksionin e Shtetit pritës, ai ka të drejtë:

- a) për një gjyq të menjëhershëm dhe të shpejtë;
- b) të informohet përpara gjykimit, për akuzën apo akuzat specifike që bëhen kundër tij;
- c) të ballafaqohet me dëshmitarët që janë kundër tij;
- d) të ketë proces të detyrueshëm për marrjen e dëshmitarëve në favor të tij, në qoftë se ata janë nën juridiksionin e Shtetit pritës;
- e) të ketë përfaqësim ligjor sipas zgjedhjes së tij për mbrojtjen e tij, ose të ketë përfaqësim ligjor falas ose ndihmës sipas kushteve që ekzistojnë për momentin në Shtetin pritës;
- f) në qoftë se ai e çmon të nevojshme, të ketë shërbimin e një përkthyesi kompetent dhe;
- g) të komunikojë me një përfaqësues të qeverisë së Shtetit dërgues dhe kur rregullat e gjykimit e lejojnë, të ketë të pranishëm në gjykimin e tij një përfaqësues të tillë.

10. a) Njësitë ose formacionet ushtarake të një force, të krijuara rregullisht, do të kenë të drejtën të ruajnë çdo kamp, ndërtesë ose mjedise të tjera që ata zënë, si rrjedhim i një marrëveshjeje me Shtetin pritës. Policia ushtarake e forcës mund të marrë të gjitha masat e përshtatshme për të siguruar ruajtjen e rendit dhe sigurisë në mjedise të tilla.

b) Jashtë këtyre mjediseve, kjo polici ushtarake mund të përdoret vetëm sipas marrëveshjeve me autoritetet e Shtetit pritës dhe në bashkëpunim me ato autoritete dhe për aq sa një përdorim i tillë është i nevojshëm për të mbajtur disiplinën dhe rendin midis anëtarëve të forcës.

11. Secila Palë Kontraktuese do të kërkojë këtë legjislacion siç e gjykon të nevojshme për të mundësuar siguri dhe mbrojtje të mjaftueshme brenda territorit të tij për instalimet, pajisjet, pasuritë, regjistrat dhe informacionet zyrtare të Palëve të tjera Kontraktuese dhe dënimin e personave që mund të shkelin ligjet e nxjerra për atë qëllim.

Neni 8

1. Çdo Palë Kontraktuese tërheq të gjitha pretendimet e saj ndaj një Pale tjetër Kontraktuese për dëmtimin e çfarëdo pasurie të saj të zotëruar nga ajo dhe të përdorur nga shërbimet e saj të armatosura tokësore, detare dhe ajrore, në qoftë se një dëmtim i tillë:

i) është shkaktuar nga një anëtar apo punonjës i shërbimeve të armatosura të Palës tjetër Kontraktuese gjatë kryerjes së detyrave të tij në lidhje me operimin e Traktatit të Atlantikut të Veriut; ose

ii) rrjedh nga përdorimi i çfarëdo automjeti, mjeti lundrues apo avioni të zotëruar nga Pala tjetër Kontraktuese dhe përdorur nga shërbimet e tij të armatosura, me kusht që ose automjeti, mjeti lundrues apo avioni që shkaktoi dëmtimin po përdorej për operacionin e Traktatit të Atlantikut të Veriut, ose që dëmtimi është shkaktuar ndaj pasurisë së përdorur në këtë mënyrë.

Pretendimet për shpëtime detare nga një Palë Kontraktuese kundër një Pale tjetër Kontraktuese do të tërhiqen, me kusht që mjeti lundrues ose ngarkesa e shpëtuar të jetë pronë e një Pale Kontraktuese dhe të përdorej nga shërbimet e saj të armatosura në lidhje me operacionet e Traktatit të Atlantikut të Veriut.

2. a) Në rastin e një dëmtimi të shkaktuar ose të lindur siç paraqitet në paragrafin 1, ndaj një pasurie tjetër të zotëruar nga një Palë Kontraktuese dhe të vendosur në territorin e saj, çështja e përgjegjësisë së cilësdo Palë tjetër Kontraktuese do të përcaktohet dhe shuma e dëmtimit do të vlerësohet, përveçse kur Palët Kontraktuese bien dakord ndryshe, nga një arbitër i vetëm i zgjedhur sipas nën-paragrafit të mëposhtëm b. të këtij paragrafi. Arbitri do të vendosë edhe për çfarëdo kundër – pretendimi që rrjedh nga i njëjti incident.

b) Arbitri i referuar në nën-paragrafin a. më lart do të zgjidhet me marrëveshje mes Palëve Kontraktuese të interesuara nga shtetasit e Shtetit pritës që mbajnë ose që kanë mbajtur poste të larta gjyqësore. Në qoftë se Palët Kontraktuese të interesuara nuk janë të afta brenda dy muajve të bien

dakord për arbitrin, secila mund t'i kërkojë Kryetarit të Përfaqësuesve në Këshillin e Atlantikut të Veriut, për të zgjedhur një person me kualifikimet e mësipërme.

c) Çdo vendim i marrë nga arbitri do të jetë i detyrueshëm dhe përfundimtar për Palët Kontraktuese.

d) Shuma e çdo dëmshpërblimi të caktuar nga arbitri do të shpërndahet në përputhje me dispozitat e paragrafit 5 e. (i), (ii) dhe (iii) të këtij Neni.

e) Kompensimi i arbitrit do të vendoset në marrëveshje midis Palëve Kontraktuese të interesuara dhe së bashku me shpenzimet e nevojshme për kryerjen e detyrave të tij, do të përballohet në pjesë të barabarta nga ana e tyre.

f) Megjithatë, çdo Palë Kontraktuese tërheq pretendimin e saj në cilindo rast të tillë kur dëmtimi është më i vogël se:

Belgjikë:	70 000 B. fr.	Luksemburg:	70 000 L. fr.
Kanada:	1 460 \$	Hollandë:	5 320 Fl.
Danimarkë:	9 670 Kr.	Norvegji:	10 000 Kr.
Francë:	490 000 F. fr.	Portugali:	40 250 Es.
Islandë:	22 800 Kr.	Mbretëria e Bashkuar:	5 00
Itali:	850 000 Li.	Shtetet e Bashkuara:	1 400 \$

g) Çdo Palë tjetër Kontraktuese pasuria e së cilës është dëmtuar në të njëjtën ngjarje do të tërheqë gjithashtu pretendimin e saj deri në shumën e mësipërme. Në rast ndryshimi të konsiderueshëm në kursin e këmbimit midis këtyre valutave, Palët Kontraktuese do të bien dakord për rregullimet e përshtatshme të këtyre shumave.

3. Për qëllime të paragrafëve 1 dhe 2 të këtij Neni, shprehja “e zotëruar nga një Palë Kontraktuese” në rastin e një anijeje përfshin një anije të regjistruar në çarterin bareboat të asaj Palë Kontraktuese ose të kërkuar nga ajo për këtë qëllim në termat e bareboat ose të konfiskuar nga ajo si çmim (përveçse në shkallën që rreziku i humbjes ose përgjegjësia mbahet nga ndonjë person tjetër i ndryshëm nga Palët Kontraktuese).

4. Secila Palë Kontraktuese tërheq të gjitha pretendimet e saj kundër cilëndo Palë tjetër Kontraktuese për plagosjen ose vdekjen e pësuar nga çdo anëtar i shërbimeve të saj të armatosura, ndërsa një anëtar i tillë është i angazhuar në kryerjen e detyrave të tij zyrtare.

5. Pretendimet (me përjashtim të pretendimeve kontraktuale dhe atyre ndaj të cilave zbatohen paragrafët 6 dhe 7 të këtij Neni) që lindin nga veprimet ose mosveprimet e anëtarëve të një force ose të një përbërësi civil të bëra gjatë kryerjes së detyrave zyrtare ose si rezultat i çfarëdo veprimi, mosveprimi apo ngjarje tjetër për të cilën një forcë apo një përbërës civil është përgjegjës dhe që shkakton dëm në territorin e Shtetit pritës ndaj palëve të treta, të ndryshme nga cilado prej Palëve Kontraktuese, do të trajtohet nga Shteti pritës në përputhje me dispozitat si vijon:

a) Pretendimet do të regjistrohen, shqyrtohen dhe vendosen ose gjykohen sipas ligjeve ose rregullave të Shtetit pritës në lidhje me pretendimet që lindin nga veprimtaritë e vetë forcave të saj të armatosura.

b) Shteti pritës mund të vendosë mbi çfarëdo pretendimesh të tilla dhe pagesa e shumës së rënë dakord ose të përcaktuar me anë të gjykimit do të bëhet nga Shteti pritës në valutën e tij.

c) Një pagesë e tillë, e bërë sipas një marrëveshjeje ose pas gjykimit të çështjes nga një gjykatë kompetente e Shtetit pritës, ose gjykimi përfundimtar nga një gjykatë e tillë që mohon pagesën do të jetë i detyrueshëm dhe përfundimtar për Palët Kontraktuese.

d) Çdo pretendim i paguar nga Shteti pritës duhet t'i komunikohet Shtetit dërgues të interesuar së bashku me hollësitat e plota dhe një shpërndarje e propozuar sipas nën-paragrafëve e. (i), (ii) dhe (iii) më poshtë. Në mungesë të një përgjigjeje brenda dy muajve, shpërndarja e propozuar do të konsiderohet si e pranuar.

e) Shpenzimet e bëra në plotësimin e pretendimeve sipas nën-paragrafëve të mëparshëm dhe paragrafit 2 të këtij Neni do të shpërndahen midis Palëve Kontraktuese si më poshtë:

i) Atje ku vetëm një Shtet dërgues është përgjegjës për shumën e caktuar ose të gjykuar, do të shpërndahen në raportin 25% të faturuar për Shtetin pritës dhe 75% të faturuar për Shtetin dërgues.

ii) Atje ku më shumë se një Shtet është përgjegjës për dëmin, shuma e caktuar ose e gjykuar, do të shpërndahet në mënyrë të rregullt midis tyre; sidoqoftë, në qoftë se Shteti pritës nuk është një nga Shtetet përgjegjëse, kontributi i tij do të jetë sa gjysma e atij të secilit nga Shtetet dërgues.

iii) Atje ku dëmi është shkaktuar nga shërbimet e armatosura të Palëve Kontraktuese dhe nuk është e mundur të ndahet në mënyrë të posaçme ndaj një apo më shumë nga ato shërbime të armatosura, shuma e caktuar ose e gjykuar do të shpërndahet në mënyrë të barabartë midis Palëve Kontraktuese të interesuara; sidoqoftë, nëse Shteti pritës nuk është një nga Shtetet, shërbimet e armatosura të të cilëve kanë shkaktuar dëmin, kontributi i tij do të jetë sa gjysma e atij të secilit nga Shtetet dërgues të interesuar.

iv) Çdo gjashtë muaj, një deklaram për shumat e paguara nga Shteti pritës në vazhden e periudhës gjashtë mujore në lidhje me çdo rast për të cilin shpërndarja e propozuar mbi baza përqindjeje është pranuar, do t'i dërgohet Shteteve dërgues të interesuar, së bashku me një kërkesë për rimbursim. Rimbursime të tilla do të bëhen brenda një kohe sa më të shkurtër në valutën e Shtetit pritës.

f) Në rastet kur zbatimi i dispozitave të nën-paragrafëve b. dhe e. të këtij paragrafi i shkakton një Pale Kontraktuese vështirësi serioze, ajo mund t'i kërkojë Këshillit të Atlantikut të Veriut të rregullojë një marrëveshje të një natyre tjetër.

g) Një anëtar i një force ose përbërësi civil nuk do t'i nënshtrohet asnjë procedure për zbatimin e çfarëdo vendimi gjykimi të dhënë kundër tij në Shtetin pritës për një çështje që lind nga kryerja e detyrave të tij zyrtare.

h) Me përjashtim të asaj që parashikohet në nën-paragrafin e. të këtij paragrafi, zbatimi ndaj pretendimeve që mbulohen në paragrafin 2 të këtij Neni, dispozitat e këtij paragrafi nuk do të zbatohen për asnjë pretendim që lind nga ose në lidhje me lundrimin apo operimin e një anijeje ose ngarkimin, transportin ose shkarkimin e një ngarkese, me përjashtim të pretendimeve për vdekje ose plagosje personale për të cilat nuk zbatohet paragrafi 4 i këtij Neni.

6. Pretendimet kundër anëtarëve të një force ose përbërësi civil që lindin nga veprime ose mosveprime të kundërligjshme në Shtetin pritës që nuk janë bërë në përputhje me kryerjen e detyrës zyrtare, do të trajtohen si më poshtë:

a) Autoritetet e Shtetit pritës do të marrin parasysh pretendimet dhe do të vlerësojnë kompensimin ndaj kërkuarit në mënyrë të ndershme dhe të drejtë, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, duke përfshirë sjelljen e personit të dëmtuar dhe do të përgatisë një raport mbi këtë çështje.

b) Raporti do t'i jepet Shtetit dërgues i cili më pas do të vendosë pa vonesë nëse ata do të ofrojnë një pagesë ex-gratia dhe nëse po, në çfarë shume.

c) Në qoftë se një ofertë pagese ex-gratia bëhet dhe pranohet nga kërkuari në përmbushje të plotë të pretendimit të tij, autoritetet e Shtetit dërgues do ta bëjnë pagesën vetë dhe do të informojnë autoritetet e Shtetit pritës për vendimin e tyre për shumën e paguar.

d) Asgjë nga ky paragraf nuk do të çënojë juridiksionin e gjykatave të Shtetit pritës që të pranojnë një pretendim kundër një anëtari të një force ose të një përbërësi civil, përveçse dhe deri atëherë kur bëhet pagesa në përmbushje të plotë të pretendimit.

7. Pretendimet që lindin nga përdorimi i paautorizuar i cilitdo automjet të shërbimeve të armatosura të një Shteti dërgues do të trajtohen në përputhje me paragrafin 6 të këtij neni, përveç se për atë që forca ose përbërësi civil të jenë ligjërisht përgjegjës.

8. Në qoftë se një mosmarrëveshje lind nëse një veprim ose mosveprim i kundërligjshëm i një anëtari të një force ose një Shteti dërgues ka qenë i paautorizuar, çështja do t'i paraqitet një arbitri të caktuar sipas paragrafit 2/b. të këtij Neni, vendimi i të cilit mbi këtë pikë do të jetë i formës së prerë dhe përfundimtar.

9. Shteti dërgues nuk do të kërkojë imunitet ndaj juridiksionit të gjykatave të Shtetit pritës për anëtarët e një force ose përbërësi civil në lidhje me juridiksionin civil të gjykatave të Shtetit pritës përveçse në shkallën e përmendur në paragrafin 5 d. të këtij Neni.

10. Autoritetet e Shtetit dërgues dhe të Shtetit pritës do të bashkëpunojnë në sigurimin e provave për një hetim të ndershëm dhe për shqyrtimin e pretendimeve për të cilat Palët Kontraktuese janë të interesuara.

Neni 9

1. Anëtarët e një force ose përbërësi civil dhe personat në varësi të tyre mund të blejnë mallra të vendit të nevojshme për konsumin e tyre vetjak dhe shërbime të tilla siç ata mund të kenë nevojë, nën të njëjtat kushte si shtetasit e Shtetit pritës.

2. Mallrat të cilat kërkohen nga burimet vendase për të siguruar mbajtjen e një force ose një përbërësi civil normalisht do të blihen nëpërmjet autoriteteve që blejnë mallra të tilla për shërbimet e armatosura të Shtetit pritës. Me qëllim që të shmanget që blerje të tilla të kenë ndonjë pasojë të pafavorshme mbi ekonominë e Shtetit pritës, autoritetet kompetente të këtij Shteti do të bëjnë të ditur, kur është e nevojshme, çdo artikull blerja e të cilit duhet të kufizohet ose të ndalohej.

3. Duke iu nënshtruar marrëveshjeve tashmë në fuqi ose që mund të arrihen më pas midis përfaqësuesve të autorizuar të Shteteve pritëse dhe dërguese, autoritetet e Shtetit pritës do të marrin përsipër përgjegjësinë e vetme për bërjen e rregullimeve të përshtatshme për të vënë në dispozicion të një force apo një përbërësi civil ndërtesat dhe tokën që ajo kërkon, si dhe mjediset dhe shërbimet që kanë lidhje me to. Këto marrëveshje dhe masa do të jenë, sa të jetë e mundur, në përputhje me rregullat që qeverisin akomodimin dhe strehimin e personelit të ngjashëm të Shtetit pritës. Në mungesë të një kontrate të posaçme të kundërt, ligjet e Shtetit pritës do të përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet që lindin nga zënia apo përdorimi i ndërtesave, tokave, mjediseve ose shërbimeve.

4. Kërkesat për fuqi punëtoresh civile vendase të një force ose përbërësi civil do të plotësohen në të njëjtën mënyrë si për kërkesat e krahasueshme të Shtetit pritës nëpërmjet shkëmbimeve të punësimit. Kushtet e punësimit dhe të punës, veçanërisht rrogat, pagesat shtesë dhe kushtet për mbrojtjen e punonjësve, do të jenë ato të përcaktuara nga legjislacioni i Shtetit pritës. Punonjës të tillë civilë të punësuar nga një forcë ose përbërës civil nuk do të konsiderohen për asnjë qëllim si anëtarë të asaj force ose përbërësi civil.

5. Kur një forcë ose përbërës civil ka, në vendin ku është stacionuar, lehtësira mjekësore ose dentare jo të përshtatshme, anëtarët e saj dhe personat në varësi të tyre mund të marrin kujdes mjekësor dhe dentar, përfshirë shtrimin në spitale sipas të njëjtave kushte si personeli i krahasueshëm i Shtetit pritës.

6. Shteti pritës do t'i kushtojë vëmendje më të favorshme kërkesave për t'u dhënë anëtarëve të një force apo të një përbërësi civil lehtësira udhëtimi dhe konçesione, në lidhje me tarifën e udhëtimit. Këto lehtësira udhëtimi dhe konçesione do t'i nënshtrohen marrëveshjeve të veçanta, për t'u arritur ndërmjet qeverive të interesuara.

7. Duke iu nënshtruar çfarëdo rregullimesh të përgjithshme apo të veçanta financiare midis Palëve Kontraktuese, pagesa në monedhën e vendit për mallra, akomodim dhe shërbime të dhëna sipas paragrafëve 2, 3, 4 dhe nëse është e nevojshme, 5 dhe 6 të këtij Neni, do të bëhen menjëherë nga autoritetet e forcës.

8. Asnjë forcë e as përbërës civil, as anëtarët e tyre, as personat në varësi të tyre, në bazë të këtij Neni, nuk do të përfitojnë çfarëdo përjashtimi nga taksat apo detyrimet në lidhje me blerjet dhe shërbimet që faturohen sipas rregullave fiskale të Shtetit pritës.

Neni 10

1. Në rastin kur veprimi ligjor i çfarëdo lloji taksimi në Shtetin pritës varet nga rezidenca apo vendbanimi, periudhat gjatë të cilave një anëtar i një force apo përbërësi civil është në territorin e atij Shteti për shkakun e vetëm të të qenit anëtar i një force apo përbërësi të tillë civil, nuk do të konsiderohen si periudha rezidence në të apo sikur krijojnë një ndryshim të rezidencës apo vendbanimit, për qëllime të një taksimi të tillë. Anëtarët e një force ose përbërësi civil do të përjashtohen nga taksimi në Shtetin pritës mbi pagat dhe shpërblimet që u jepen atyre si anëtarë të tillë nga Shteti dërgues ose mbi një pasuri tjetër të tundshme e të prekshme, prania e së cilës në Shtetin pritës është vetëm për qëndrimin e tyre të përkohshëm atje.

2. Asgjë në këtë Nen nuk do të pengojë taksimin e një anëtari të një force ose përbërësi civil në lidhje me ndonjë ndërmarrje fitimprurëse, të ndryshme nga punësimi si anëtar i një force të tillë, në

të cilën ai mund të jetë përfshirë në Shtetin pritës si dhe, me përjashtim të sa lidhet me pagën dhe shpërblimet e tij, si dhe me pasurinë e tundshme të prekshme e cila referohet në paragrafin 1, asgjë në këtë Nen nuk do të pengojë taksimin për të cilin edhe nëse mendohet se e ka rezidencën apo vendbanimin jashtë territorit të Shtetit pritës, një anëtar i tillë është përgjegjës sipas ligjit të atij Shteti.

3. Asgjë në këtë nen nuk do të zbatohet për 'detyrimet doganore' ashtu siç është përcaktuar në paragrafin 12 të nenit XI.

4. Për qëllimin e këtij Neni, termi "anëtar i një force" nuk do të përfshijë atë person që është Shtetas i Shtetit pritës.

Neni 11

1. Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe e në mënyrë të kundërt në këtë Marrëveshje, anëtarët e një force dhe të një përbërësi civil, si dhe personat në varësi të tyre do t'i nënshtrohen ligjeve dhe rregullave të vendosura nga autoritetet e doganave të Shtetit pritës. Në veçanti, autoritetet doganore të Shtetit pritës do të kenë të drejtën, sipas kushteve të përgjithshme të përcaktuara nga ligjet dhe rregullat e Shtetit pritës, për të kontrolluar anëtarët e një force ose të një përbërësi civil dhe personat në varësi të tyre dhe të kontrollojnë bagazhet dhe automjetet e tyre, si dhe të konfiskojnë artikuj sipas ligjeve dhe rregullave të këtij lloji.

2. a) Importimi i përkohshëm dhe ri-eksportimi i automjeteve të shërbimit të një force apo përbërësi civil nën komandën e vetë atyre, do të autorizohen pa tarifë doganore me paraqitjen e një triptiku sipas formularit të paraqitur në Shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

b) Importimi i përkohshëm i automjeteve të tilla që nuk janë nën komandën e tyre do të trajtohet sipas paragrafit 4 të këtij Neni dhe ri-eksportimi i tyre sipas paragrafit 8.

c) Automjetet e shërbimit të një force apo përbërësi civil do të përjashtohen nga çfarëdo takse e pagueshme lidhur me përdorimin e automjeteve në rrugë.

3. Dokumentet zyrtare me vula zyrtare nuk do t'i nënshtrohen kontrollit doganor. Korrierët, çfarëdo lloj statusi që të kenë, që mbajnë këto dokumente duhet të jenë të pajisur me një urdhër individual lëvizjeje, të lëshuar në përputhje me paragrafin 2 b. të Nenit III. Ky urdhër lëvizjeje do të tregojë numrin e dërgesave të bëra dhe do të vërtetojë se ato përmbajnë vetëm dokumente zyrtare.

4. Një forcë mund të importojë pa tarifë doganore pajisje për forcën dhe sasi të arsyeshme ushqimesh, furnizimesh dhe mallra të tjera për përdorim ekskluziv të forcës dhe në rastet kur ky përdorim lejohet nga Shteti pritës, edhe për përbërësit e saj civilë dhe personat në varësi. Importimi pa doganë do t'i nënshtrohet depozitimit në zyrën e doganave për vendin e hyrjes, së bashku me dokumente doganore të tilla të rëna dakord, të një certifikate në formën e rënë dakord ndërmjet Shtetit pritës dhe Shtetit dërgues, të nënshkruar nga një person i autorizuar për këtë qëllim nga Shteti dërgues. Përcaktimi i personit të autorizuar për të nënshkruar certifikatat si dhe i modeleve të nënshkrimeve dhe pullave që do të përdoren, do t'i dërgohet administratës doganore të Shtetit pritës.

5. Një anëtar i një force ose përbërësi civil mundet që, në momentin e arritjes së tij të parë të marrë shërbimin në Shtetin dërgues ose në kohën e arritjes së parë të cilitdo person në varësi të tij për t'u bashkuar me të, të importojë sendet e tij vetjake dhe mobilet pa pagesë për kohëzgjatjen e një shërbimi të tillë.

6. Anëtarët e një force ose përbërësi civil mund të importojnë përkohësisht, pa tarifë doganore, mjetet e tyre private motorike për përdorimin vetjak të tyre dhe të personave në varësi të tyre. Nuk ka asnjë detyrim sipas këtij Neni për të njohur përjashtime nga taksat e pagueshme në lidhje me përdorimin e rrugëve nga automjetet private.

7. Importet e bëra nga autoritetet e një force me përjashtim të atyre për përdorim ekskluziv nga ajo forcë dhe përbërësi i saj civil, dhe importet e ndryshme nga ato që trajtohen nga paragrafi 5 dhe 6 i këtij Neni, të kryera nga anëtarët e një force ose përbërësi civil, nuk kanë, në bazë të këtij neni, asnjë të drejtë për çfarëdo përjashtimi nga detyrimet doganore apo kushte të tjera.

8. Mallrat që janë importuar pa tarifa doganore sipas paragrafëve 2 b., 4, 5 ose 6 më sipër:

a) mund të ri-eksportohen falas, me kusht që, në rastet e mallrave të importuara sipas paragrafit 4, një certifikatë e lëshuar në përputhje me atë paragraf t'i paraqitet zyrës së doganore, megjithatë, autoritetet doganore mund të verifikojnë se mallrat e ri-eksportuara janë ashtu siç përshkruhen në certifikatë, nëse ka ndonjë, dhe në fakt janë importuar sipas kushteve të paragrafit 2 b.,

4, 5 ose 6, sipas rastit.

b) normalisht nuk mund të lihen në Shtetin pritës ose me anë të shitjes ose dhurimit; megjithatë, në raste të veçanta, largime të tilla mund të autorizohen në bazë të kushteve të vendosura nga autoritetet e interesuara të Shtetit pritës (p.sh. për pagesën e taksave dhe detyrimeve doganore dhe në përputhje me kërkesat e kontroleve të tregtisë dhe shkëmbimit).

9. Mallrat e blera në Shtetin pritës do të eksportohen prej andej vetëm në përputhje me rregullat në fuqi në Shtetin pritës.

10. Rregullime të posaçme për kalimin e kufijve do të mundësohen nga autoritetet doganore njëjse apo formacioneve të krijuara rregullisht, me kusht që autoritetet doganore të interesuara të jenë njoftuar më parë në mënyrën e duhur.

11. Marrëveshje të veçanta do të bëhen nga Shteti pritës me qëllim që lënda djegëse, vaji dhe lubrifikantet për përdorim nga automjetet e shërbimit, avionët dhe anijet e një force apo përbërësi civil, të lëvrohen pa asnjë taksë apo tatim.

12. Në paragrafët 1-10 të këtij neni:

“detyrim” nënkupton detyrimet doganore dhe të gjitha taksat dhe tatimet e tjera të pagueshme mbi importin dhe eksportin, sipas rastit, me përjashtim të pagesave dhe taksave të cilat janë jo më shumë se sa taksa për shërbimet e kryera;

“importim” përfshin tërheqje nga depot e doganave ose nga ruajtja e vazhdueshme doganore, me kusht që këto artikuj të mos jenë rritur, prodhuar ose përpunuar në Shtetin pritës.

13. Kushtet e këtij Neni do të zbatohen për mallrat në fjalë jo vetëm kur ato importohen ose eksportohen nga Shteti pritës, por edhe kur ato janë në tranzit nëpër territorin e një Pale Kontraktuese dhe për këtë qëllim shprehja “Shtet pritës” në këtë Nen do të konsiderohet se përfshin edhe një Palë Kontraktuese nëpërmjet territorit të së cilës mallrat kalojnë në tranzit.

Neni 12

1. Autoritetet doganore ose fiskale të Shtetit pritës mund që, si kusht për dhënien e ndonjë përjashtimi doganor apo fiskal ose koncesion të paraqitur në këtë Marrëveshje, të kërkojnë që kushte të tilla të respektohen në mënyrën që ata e vlerësojnë të nevojshme për të parandaluar shpërdorimin.

2. Këto autoritete mund të refuzojnë çfarëdo përjashtimi të parashikuar nga kjo Marrëveshje në lidhje me importimin në Shtetin pritës të artikujve të rritur, prodhuar apo përpunuar në atë Shtet, që janë eksportuar prej andej pa paguar taksat ose detyrimet ose pas shlyerjes së taksave dhe detyrimeve, të cilat duhet të kishin qenë vendosur përveçse për një eksportim të tillë. Mallrat që lëvizin nga një depo dogane do të konsiderohen sikur të jenë importuar në qoftë se ato ishin konsideruar si të kenë qenë eksportuar për shkak se ato kanë qenë depozituar në depo.

Neni 13

1. Me qëllim që të parandalojnë shkeljet ndaj ligjeve dhe rregullave doganore dhe fiskale, autoritetet e Shteteve dërguese dhe pritëse do të ndihmojnë njëri – tjetrin në kryerjen e hetimeve dhe mbledhjen e provave.

2. Autoritetet e një force do të japin të gjithë ndihmën brenda kompetencës së tyre për të siguruar që artikujt e prirur për tu konfiskuar nga ose në emër të doganave ose autoriteteve fiskale të Shtetit pritës t’u dorëzohen atyre autoriteteve.

3. Autoritetet e një force do të japin të gjithë ndihmën brenda kompetencës së tyre për të siguruar pagesën e detyrimeve, taksave dhe dënimeve të pagueshme nga anëtarët e forcës ose përbërësit civilë apo personat në varësi të tyre.

4. Automjetet e shërbimit dhe artikujt që i takojnë një force ose përbërësit të saj civil dhe jo një anëtar të një force të tillë apo të përbërësit civil, të konfiskuara nga autoritetet e Shtetit pritës në lidhje me një shkelje ndaj ligjeve ose rregullave doganore ose fiskale, duhet t’u dorëzohen autoriteteve përkatëse të forcës së interesuar.

Neni 14

1. Një forcë, një përbërës civil dhe anëtarët përkatës, si dhe personat në varësi të tyre, do të vazhdojnë t'i nënshtrohen rregulloreve mbi këmbimin e huaj të Shtetit dërgues dhe do t'i nënshtrohen gjithashtu rregulloreve të Shtetit pritës.

2. Autoritetet për këmbimin e huaj si të Shtetit pritës dhe të atij dërgues mund të nxjerrin rregullore të posaçme të zbatueshme ndaj një force apo një përbërësi civil ose anëtarëve përkatës, si dhe ndaj personave në varësi të tyre.

Neni 15

1. Sipas paragrafit 2 të këtij neni, kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi në rast veprimesh luftarake që Traktati i Atlantikut të Veriut vë në zbatim, me përjashtim kur kushtet për zgjidhjen e pretendimeve në paragrafët 2 dhe 5 të nenit 8 nuk do të zbatohen ndaj dëmtimeve të luftës dhe se kushtet e Marrëveshjes, e në veçanti të nenit 3 dhe 7 do të rishikohen menjëherë nga Palët Kontraktuese të interesuara, të cilat mund të bien dakord për modifikime të tilla që ato i konsiderojnë të nevojshme në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes midis tyre.

2. Në rast veprimesh të tilla luftarake, çdo Palë Kontraktuese do të ketë të drejtën duke i dhënë një njoftim prej gjashtëdhjet ditësh Palës tjetër Kontraktuese për të pezulluar zbatimin e cilitdo nga kushtet e kësaj Marrëveshje për aq sa të jetë e interesuar. Në qoftë se ushtrohet kjo e drejtë, Palët Kontraktuese do të këshillohen menjëherë me qëllim që të bien dakord për kushte të përshtatshme për të zëvendësuar kushtet që u pezulluan.

Neni 16

Të gjitha mosmarrëveshjet mes Palëve Kontraktuese në lidhje me interpretimin apo zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen me bisedime midis tyre, pa kërkuar ndihmë tek ndonjë juridiksion i jashtëm. Me përjashtim kur dispozita e shprehur bëhet në kundërshtim me këtë Marrëveshje, mosmarrëveshjet që nuk mund të zgjidhen me bisedime të drejtpërdrejta duhet t'i referohen Këshillit të Atlantikut të Veriut.

Neni 17

Çdo Palë Kontraktuese mundet që në çdo kohë të kërkojë rishikim të çdo neni të kësaj Marrëveshjeje. Kërkesat do t'i drejtohen Këshillit të Atlantikut të Veriut.

Neni 18

1. Kjo Marrëveshje do të ratifikohet dhe instrumentet e ratifikimit do të depozitohen sa më shpejt që të jetë e mundur pranë Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila do të informojë çdo Shtet nënshkrues për datën e depozitimit të saj.

2. Tridhjet ditë pasi katër Shtete nënshkruese të kenë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ndërmjet tyre. Ajo do të hyjë në fuqi për çdo Shtet tjetër nënshkrues 30 ditë pas depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit.

3. Pasi të ketë hyrë në fuqi, kjo Marrëveshje, me miratimin e Këshillit të Atlantikut të Veriut dhe në bazë të kushteve që ai mund të vendosë, do të jetë e hapur ndaj çfarëdo aderimi në emër të ndonjë Shteti i cili aderon në Traktatin e Atlantikut të Veriut. Ky aderim do të bëhet me anë të depozitimit të çdo instrumenti aderimi pranë Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila do të informojë çdo Shtet nënshkrues dhe çdo Shtet aderues për datën e depozitimit të saj. Për sa i përket çdo Shteti në emër të të cilit depozitohet një instrument aderimi, kjo Marrëveshje hyn në fuqi tridhjet ditë pas datës së depozitimit të një instrumenti të tillë.

Neni 19

1. Kjo Marrëveshje mund të denoncohet nga çdo Palë Kontraktuese pas përfundimit të një periudhe katër vjeçare nga data në të cilën Marrëveshja hyn në fuqi.

2. Denoncimi i Marrëveshjes nga çdo Palë Kontraktuese do të bëhet me anë të një njoftimi me shkrim, që ajo Palë Kontraktuese ia drejton Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila do të informojë të gjitha Palët e tjera Kontraktuese për secilin nga këto njoftime dhe datën e marrjes prej saj.

3. Denoncimi do të hyjë në fuqi një vit pas marrjes së njoftimit nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Pas përfundimit të kësaj periudhe një vjeçare, Marrëveshja do të pushojë së ekzistuari lidhur me Palën Kontraktuese që e denoncoi atë, por ajo do të vazhdojë të jetë në fuqi për Palët Kontraktuese të mbetura.

Neni 20

1. Sipas kushteve të paragrafit 2 dhe 3 të këtij neni, kjo Marrëveshje do të zbatohet vetëm për territorin e kryeqytetit të një Pale Kontraktuese.

2. Megjithatë, çdo Shtet mundet në çdo kohë të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit ose aderimit, ose në çdo kohë pas saj, të deklarojë me njoftim zyrtar drejtuar Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës se kjo Marrëveshje do të shtrihet (në qoftë se Shteti që bën deklaratën e çmon atë të nevojshme, me përfundimin e një marrëveshje të veçantë midis atij Shteti dhe çdo Shteti të interesuar) në të gjitha ose në ndonjë territor për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit ai është përgjegjës në zonën e Traktatit të Atlantikut të Veriut. Pas kësaj, kjo Marrëveshje do të shtrihet në territorin apo territoret e përmendura atje tridhjet ditë pas marrjes nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës të njoftimit ose tridhjet ditë pas përfundimit të marrëveshjeve të veçanta, në qoftë se kjo kërkohet ose kur ajo ka hyrë në fuqi sipas Nenit 18, cilado qoftë e fundit.

3. Një Shtet që ka bërë një deklaratë sipas paragrafit 2 të këtij Neni duke shtrirë këtë marrëveshje në çdo territor për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit është përgjegjës, mund të denoncojë Marrëveshjen në lidhje me atë territor veçmas, sipas dispozitave të nenit XIX.

Në dëshmi sa më sipër, të Plotfuqishmit e nënshkruar kanë firmosur këtë Marrëveshje.

Bërë në Londër më 19 qershor 1951, në gjuhën angleze dhe frënge, duke qenë të dy tekstet njëllorj autentike, në një origjinal të vetëm i cili do të depozitohet në arkivat e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës do t'i përcjellë kopje të vërtetuara të saj të gjithë Shteteve nënshkruese dhe atyre aderuese.

LIGJ

Nr.10 102, datë 26.3.2009

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES PËR STATUSIN E ORGANIZATËS SË TRAKTATIT TË ATLANTIKUT TË VERIUT, TË PËRFAQËSUESVE KOMBËTARË DHE PERSONELIT NDËRKOMBËTAR”

Në mbështetje të neneve 2 pika 3, 83 pika 1, 84 pika 4 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja për statusin e Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut, të përfaqësuesve kombëtarë dhe personelit ndërkombëtar”, bërë në Otava më 19 shtator 1951.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MARRËVESHJE

MBI STATUSIN E ORGANIZATËS SË ATLANTIKUT TË VERIUT, PËRFAQËSUESIT VENDAS DHE PERSONELIT NDËRKOMBËTAR

Shtetet nënshkruese në këtë Marrëveshje,
duke pasur parasysh se për ushtrimin e funksioneve të tyre dhe për plotësimin e qëllimeve të tyre është e nevojshme që Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut, personeli i saj ndërkombëtar dhe përfaqësuesit e Shteteve Anëtare që ndjekin takimet e saj duhet të kenë statusin e përcaktuar në vazhdim,

kanë rënë dakord për sa vijon:

PJESA I TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Në këtë Marrëveshje,

a) “Organizata” nënkupton Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut që përbëhet nga Këshilli dhe organet e tij ndihmëse.

b) “Këshilli” nënkupton këshillin e krijuar sipas nenit IX të Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe Përfaqësuesit në Këshill;

c) “organe ndihmëse” nënkupton çdo organ, komitet apo shërbim të ngritur nga Këshilli ose nën autoritetin e tij, përveç atyre ndaj të cilave nuk zbatohet kjo Marrëveshje, në përputhje me Nenin II;

d) “Kryetar i përfaqësuesve në Këshill” përfshin, në mungesë të tij, nënkryetarin që vepron për të.

Neni 2

Kjo Marrëveshje nuk do të zbatohet për asnjë shtab ushtarak të ngritur në përputhje me Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe për asnjë organ tjetër ushtarak, përveç kur këshilli vendos ndryshe.

Neni 3

Organizata dhe Shtetet Anëtare do të bashkëpunojnë në çdo kohë për të lehtësuar administrimin e duhur të drejtësisë, për të siguruar zbatimin e rregulloreve të policisë dhe për të parandaluar ndodhjen e çfarëdo abuzimi në lidhje me imunitetet dhe privilegjet e përcaktuara në këtë Marrëveshje. Në qoftë se cilido Shtet Anëtar quan se ka pasur një abuzim me cilindo imunitet apo privilegj të dhënë sipas kësaj Marrëveshje, do të mbahen diskutime ndërmjet atij Shteti dhe Organizatës ose ndërmjet Shteteve të interesuara, për të përcaktuar nëse ka ndodhur një abuzim i tillë

dhe nëse është kështu, për të bërë përpjekje për të siguruar që mos të ketë përsëritje të tij. Pavarësisht nga sa u tha më sipër apo nga cilado dispozitë tjetër e kësaj Marrëveshje, një Shtet Anëtar i cili quan se cilido person ka abuzuar me privilegjin e tij të vendbanimit apo me çdo imunitet apo privilegj tjetër të dhënë sipas kësaj Marrëveshje mund t'i kërkojë këtij personi që të largohet nga territori i tij.

PJESA II ORGANIZATA

Neni 4

Organizata do të ketë personalitet juridik; ajo do të ketë aftësinë për të përfunduar kontrata, për të blerë dhe disponuar pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme si edhe për të nisur procedime ligjore.

Neni 5

Organizata, pasuritë dhe pronat e saj, kudo që të ndodhen e nga kushdo që të mbahen, do të gëzojnë imunitet nga çdo formë e procesit ligjor përveç kur në çdo rast të veçantë Kryetari i Përfaqësuesve në Këshill, duke vepruar në emër të organizatës, mund të autorizojë shprehimisht heqjen e këtij imuniteti. Vetëkuptohet sidoqoftë, se asnjë heqje e imunitetit nuk do të shtrihet deri në ndonjë mase ekzekutimi apo ndalimi të pasurisë.

Neni 6

Mjediset e organizatës do të jenë të paprekshme. Pasuritë dhe pronat e saj, kudo që të ndodhen e nga kushdo që të mbahen, do të gëzojnë imunitet nga kontrollet, sekuestrimet, konfiskimet, shpronësimet apo nga çdo formë tjetër ndërhyrje.

Neni 7

Arkivat e organizatës dhe të gjitha dokumentet që i përkasin asaj apo që mbahen nga ajo do të jenë të paprekshme, kudo që të ndodhen.

Neni 8

1. Pa u kufizuar nga kontrollet financiare, rregulloret apo moratoriumet e çfarëdo lloji,
 - a) Organizata mund të mbajë valutë të çfarëdo lloji dhe të operojë llogari në çfarëdo lloj valute;
 - b) Organizata mund të transferojë lirisht fondet e saj nga një vend në një tjetër apo brenda cilitdo vend dhe mund të këmbejë çdo valutë që ajo mban në çfarëdo lloj valute tjetër në kursin më të favorshëm zyrtar të këmbimit për një shitje apo blerje siç mund të jetë rasti.
2. Në ushtrimin e të drejtave të saj sipas paragrafit 1 më lart, organizata do t'i japë vëmendjen e duhur çdo parashtrimi të bërë nga cilido Shtet Anëtar dhe do t'i japë fuqi parashtrimeve të tilla për aq sa është e arsyeshme për të vepruar kështu.

Neni 9

- Organizata, pasuritë, të ardhurat dhe pronat e tjera të saj do të përjashtohen:
- a) nga të gjitha taksat e drejtpërdrejta; Organizata sidoqoftë nuk do të kërkojë përjashtim nga tarifati, taksat apo detyrimet që nuk janë tjetër veçse tarifa për shërbime komunale publike;
 - b)) nga të gjitha detyrimet doganore dhe kufizimet sasiore mbi importet dhe eksportet në lidhje me artikujt e importuar apo eksportuar nga Organizata për përdorimin e saj zyrtar; artikujt e importuar sipas përjashtimeve të tilla nuk do të disponohen, as me shitje e as me dhurim, në vendin në të cilin ato importohen përveçse sipas kushteve të miratuara nga Qeveria e atij vendi;
 - c)) nga të gjitha detyrimet doganore dhe kufizimet sasiore mbi importet dhe eksportet në lidhje me publikimet e saj.

Neni 10

Ndërsa organizata, si rregull i përgjithshëm, nuk do të kërkojë përjashtim nga detyrimet për taksat indirekte dhe nga taksat mbi shitjen e pasurisë të luajtshme apo të paluajtshme që përbëjnë pjesë të çmimit për tu paguar, sidoqoftë, kur Organizata është duke bërë blerje të rëndësishme për përdorimin zyrtar të pronave mbi të cilat janë vënë apo është e mundur të vihen detyrimet dhe taksa të tilla, Shtetet Anëtare kurdoherë që është e mundur do të bëjnë rregullimet e përshtatshme administrative për shlyerjen apo kthimin e shumës së detyrimit apo taksës.

Neni 11

1. Asnjë censurë nuk do të zbatohet ndaj korrespondencës zyrtare dhe komunikimeve të tjera zyrtare të Organizatës.

2. Organizata do të ketë të drejtën të përdorë kode si edhe të dërgojë e marrë korrespondencën me korrier apo në çanta të vulosura, të cilat do të kenë të njëjtat imunitete dhe privilegje si korrierët dhe çantat diplomatike.

3. Asgjë në këtë nen nuk do të interpretohet sikur pengon marrjen e masave paraprake të përshtatshme të sigurisë siç do të përcaktohen me marrëveshje ndërmjet një Shteti Anëtar dhe Këshillit që vepron në emër të organizatës.

PJESA III PËRFAQËSUESIT E SHTETEVE ANËTARE

Neni 12

Çdo person i përcaktuar nga një Shtet Anëtar si përfaqësuesi i tij kryesor i përhershëm në organizatë në territorin e një Shteti tjetër Anëtar, dhe anëtarë të tjerë të personelit të tij zyrtar që banojnë në atë territor siç mund të bihet dakord ndërmjet Shtetit që i ka caktuar ata dhe organizatës, si edhe ndërmjet organizatës dhe shtetit në të cilën ata do të banojnë, do të gëzojë imunitetet dhe privilegjet që i janë dhënë përfaqësuesve diplomatikë dhe personelit të tyre zyrtar në një gradë të krahasueshme.

Neni 13

1. Cilido përfaqësues i një Shteti Anëtar në Këshill ose cilindo nga organet e tij ndihmëse i cili nuk mbulohet nga neni XII, ndërsa është i pranishëm në territorin e një Shteti tjetër Anëtar për kryerjen e detyrave të tij, gëzon privilegjet dhe imunitetet si vijon:

a) të njëjtin imunitet nga arrestimi apo ndalimi personal si ai që i është dhënë personelit diplomatik në një gradë të krahasueshme;

b) në lidhje me fjalët e folura ose të shkruara dhe të veprimeve të bëra nga ai në cilësinë e tij zyrtare, imunitet nga procesi ligjor;

c) paprekshmërinë e të gjitha letrave dhe dokumenteve;

d) të drejtën për të përdorur kode dhe për të marrë e dërguar dokumente apo korrespondencë me anë të korrierit apo në çanta të vulosura;

e) të njëjtin përjashtim në lidhje me atë vetë dhe me bashkëshorten e tij nga kufizimet mbi imigrimin, regjistrimin e të huajve dhe detyrimet për shërbim kombëtar si ai që i është dhënë personelit diplomatik në një gradë të krahasueshme;

f) të njëjtat lehtësira në lidhje me kufizimet mbi valutën apo këmbimin e saj siç u janë dhënë personelit diplomatik në një gradë të krahasueshme;

g) të njëjtat imunitete dhe lehtësira në lidhje me bagazhet e tij vetjake si ai që i është dhënë personelit diplomatik në një gradë të krahasueshme;

h) të drejtën për të importuar pa paguar taksë doganore mobiliat dhe sendet e tij vetjake në kohën e mbërritjes së parë për të marrë detyrën e tij në vendin në fjalë, dhe me përfundimin e

funksioneve të tij në atë vend, për t'i rieksportuar këto mobilie dhe sende pa paguar taksë doganore, duke iu nënshtruar në secilin rast kushteve të tilla që mund të vlerësojë si të nevojshme Qeveria e vendit në të cilin është duke u ushtruar e drejta;

i) të drejtën për të importuar përkohësisht pa paguar taksë doganore mjetin e tij privat të motorizuar për përdorimin e tij vetjak dhe në vijim për ta rieksportuar një mjet të tillë pa paguar taksë doganore, duke iu nënshtruar në secilin rast kushteve të tilla që mund të vlerësojë si të nevojshme Qeveria e vendit të interesuar.

2. Atje ku parashikimi ligjor i çdo forme taksimi varet nga vendbanimi, periudha gjatë së cilës një përfaqësues ndaj të cilit zbatohet ky Nen është i pranishëm në territorin e një Shteti tjetër Anëtar për kryerjen e detyrave të tij, nuk do të quhet si periudhë banimi. Në veçanti, ai do të përjashtohet nga taksimi mbi pagën dhe shpërblimet e tij zyrtare gjatë periudhave të tilla në detyrë.

3. Në këtë nen "përfaqësues" do të quhet se përfshin të gjithë përfaqësuesit, këshilltarët dhe ekspertët teknikë të delegacioneve. Secili Shtet Anëtar do t'i komunikojë Shteteve të tjera Anëtare të interesuara, nëse ato e kërkojnë këtë gjë, emrat e përfaqësuesve të tij ndaj të cilëve zbatohet ky nen dhe kohëzgjatjen e mundshme të qëndrimit të tyre në territoret e këtyre shteteve.

Neni 14

Personelit zyrtar mbështetës që shoqëron një përfaqësues të një Shteti Anëtar që nuk mbulohet nga nenet XII ose XIII, ndërsa janë të pranishëm në territorin e një Shteti tjetër Anëtar për kryerjen e funksioneve të tyre, do t'i jepen privilegjet dhe imunitetet e përcaktuara në paragrafin 1 b., c., e., f., h. dhe i., si edhe në paragrafin 2 të nenit XIII.

Neni 15

Privilegjet dhe imunitetet i jepen përfaqësuesve të Shteteve Anëtare dhe personelit të tyre jo për përfitimin personal të vetë individëve por me qëllim që të ruajnë ushtrimin e pavarur të funksioneve të tyre në lidhje me Traktatin e Atlantikut të Veriut. Si rrjedhim, një Shtet Anëtar ka jo vetëm të drejtën por edhe detyrimin për të hequr imunitetin e përfaqësuesve të tij dhe anëtarëve të personelit të tyre në cilindo rast kur, sipas mendimit të tij, imuniteti do të pengonte rrjedhën e drejtësisë dhe mund të hiqet pa cenuar qëllimet për të cilat imuniteti është dhënë.

Neni 16

Dispozitat e neneve nga XII deri në XIV më lart nuk do t'i kërkojnë asnjë shteti që të japë cilindo nga privilegjet dhe imunitetet e referuara aty ndaj cilitdo person që është shtetas i vet apo ndaj cilitdo person si përfaqësuesi i tij apo anëtar i personelit të këtij përfaqësuesi.

PJESA IV

PERSONELI NDËRKOMBËTAR DHE EKSPERTËT NË MISIONE PËR ORGANIZATËN

Neni 17

Kategoritë e zyrtarëve të organizatës ndaj të cilëve zbatohen nenet nga XVIII deri në XX do të bihen dakord ndërmjet Kryetarit të Përfaqësuesve në Këshill dhe secilit nga Shtetet Anëtare të interesuara. Kryetari i Përfaqësuesve në Këshill do t'i komunikojë Shteteve Anëtare emrat e zyrtarëve të përfshirë në këto kategori.

Neni 18

Zyrtarët e organizatës për të cilët është rënë dakord sipas nenit XVII:

a) do të gëzojnë imunitet nga procesi ligjor në lidhje me fjalët e folura apo të shkruara dhe me veprimet e kryera prej tyre në cilësinë e tyre zyrtare dhe brenda kufijve të autoritetit të tyre;

b) do tu jepen, së bashku me bashkëshortet e tyre dhe me anëtarët e familjes së tyre të ngushtë që banojnë me ta e që varen prej tyre, të njëjtat imunitete nga kufizimet mbi imigrimin dhe regjistrimin e të huajve siç u jepen personelit diplomatik në një gradë të krahasueshme;

c) do tu jepen të njëjtat lehtësira në lidhje me kufizimet mbi valutën apo këmbimin e saj siç u janë dhënë personelit diplomatik në një gradë të krahasueshme;

d) do tu jepen të njëjtat lehtësira, së bashku me bashkëshortet e tyre dhe me anëtarët e familjes së tyre të ngushtë që banojnë me ta e që varen prej tyre, për riatdhesimin në kohë krizash ndërkombëtare si ato që i janë dhënë personelit diplomatik në një gradë të krahasueshme;

e) do të kenë të drejtën për të importuar pa paguar taksë doganore mobiliet dhe sendet e tyre në kohën e mbërritjes së parë për të marrë detyrën e tyre në vendin në fjalë, dhe me përfundimin e funksioneve të tyre në atë vend, për t'i rieksportuar këto mobilie dhe sende pa paguar taksë doganore, duke iu nënshtruar në secilin rast kushteve të tilla që mund të vlerësojë si të nevojshme Qeveria e vendit në të cilin është duke u ushtruar e drejta;

f) do të kenë të drejtën për të importuar përkohësisht pa paguar taksë doganore mjetet e tyre private të motorizuara për përdorimin e tyre vetjak dhe në vijim për t'i rieksportuar këto mjete pa paguar taksë doganore, duke iu nënshtruar në secilin rast kushteve të tilla që mund të vlerësojë si të nevojshme qeveria e vendit të interesuar.

Neni 19

Zyrtarët e organizatës për të cilët është rënë dakord sipas nenit XVII do të përjashtohen nga taksimi mbi pagat dhe shpërblimet që u paguhen atyre nga Organizata në cilësinë e tyre si zyrtarë të tillë. Cilido Shtet Anëtar mundet që, sidoqoftë, të arrijë një rregullim me Këshillin që vepron në emër të organizatës përmes së cilës ky Shtet Anëtar do të punësojë dhe caktojë në organizatë të gjithë shtetasit e vet (përveç, nëse Shteti Anëtar kështu dëshiron, çdo personi banues jo i përhershëm brenda territorit të tij) që do të shërbejnë në personelin ndërkombëtar të organizatës dhe të paguajë pagat dhe shpërblimet nga fondet e veta sipas një niveli të caktuar nga ai vetë. Pagat dhe shpërblimet e paguara në këtë mënyrë mund të taksohen nga ky Shtet Anëtar por përjashtohen nga taksat e cilitdo Shteti tjetër Anëtar. Në rast se një rregullim i tillë është bërë nga cilido Shtet Anëtar dhe më vonë është modifikuar ose përfunduar, Shtetet Anëtare nuk do të jenë më të detyruara sipas fjalisë së parë të këtij neni për të përjashtuar nga taksat pagat dhe shpërblimet që i paguhen shtetasve të tyre.

Neni 20

Përveç imuniteteve dhe privilegjeve të përcaktuara në nenet XVIII dhe XIX, Sekretarit Ekzekutiv të Organizatës, Koordinatorit të Prodhimit të Mbrojtjes së Atlantikut të Veriut dhe zyrtarëve të tjerë të përhershëm me gradë të ngjashme siç mund të bihet dakord ndërmjet Kryetarit të Përfaqësuesve në Këshill dhe Qeverive të Shteteve Anëtare, do t'u jepen privilegje dhe imunitete që i jepen normalisht personelit diplomatik në gradë të krahasueshme.

Neni 21

1. Ekspertëve (përveç zyrtarëve që parashikohen brenda qëllimit të neneve nga XVIII deri në XX) që janë të punësuar në misione në emër të organizatës do t'u jepen privilegjet dhe imunitetet në vijim për aq sa është e nevojshme për ushtrimin e efektshëm të funksioneve të tyre, ndërsa janë të pranishëm në territorin e një Shteti Anëtar për kryerjen e detyrave të tyre:

a) Imunitet nga arrestimi apo ndalimi personal si edhe nga sekuestrimi i bagazheve të tyre personale;

b) Në lidhje me fjalët e folura apo të shkruara dhe me veprimet e kryera prej tyre në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare për organizatën, imunitet nga procesi ligjor;

c) të njëjtat lehtësi në lidhje me kufizimet mbi valutën apo këmbimin e saj dhe në lidhje me bagazhet e tyre siç u janë dhënë zyrtarëve të qeverive të huaja në misione zyrtare të përkohshme;

d) paprekshmërinë e të gjitha letrave dhe dokumenteve që lidhen me punën në të cilën ata janë

të përfshirë për organizatën.

2. Kryetari i Përfaqësuesve në Këshill do t'i komunikojë Shteteve Anëtare të interesuara emrat e cilitdo ekspert për të cilin zbatohet ky nen.

Neni 22

Privilegjet dhe imunitetet i jepen zyrtarëve dhe ekspertëve në interes të organizatës jo për përfitimin personal të vetë individëve. Kryetari i Përfaqësuesve në Këshill ka të drejtën dhe detyrimin për të hequr imunitetin e cilitdo zyrtar apo ekspert në cilindo rast kur, sipas mendimit të tij, imuniteti do të pengonte rrjedhën e drejtësisë dhe mund të hiqet pa cenuar interesat e organizatës.

Neni 23

Dispozitat e neneve XVIII, XX dhe XXI më lart nuk do t'i kërkojnë asnjë shteti që të japë cilindo nga privilegjet dhe imunitetet e referuara aty ndaj cilitdo person që është shtetas i vet, përveç:

a) Imunitet nga procesi ligjor në lidhje me fjalët e folura apo të shkruara dhe me veprimet e kryera prej tij në përmbushje të funksioneve të tij zyrtare për organizatën;

b) paprekshmërinë e të gjitha letrave dhe dokumenteve që lidhen me punën në të cilën ai është i përfshirë për organizatën;

c) lehtësi në lidhje me kufizimet mbi valutën apo këmbimin e saj për aq sa është e nevojshme për ushtrimin e efektshëm të funksioneve të tij.

PJESA V ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 24

Këshilli do të sigurojë mënyrat e përshtatshme të zgjidhjes së:

a) mosmarrëveshjeve që rrjedhin nga kontratat apo mosmarrëveshje të tjera të një karakteri privat në të cilat është palë organizata;

b) mosmarrëveshjeve që përfshijnë cilindo zyrtar apo ekspert të organizatës për të cilin zbatohet pjesa IV e kësaj Marrëveshjeje, i cili, për shkak të pozitës së tij zyrtare, gëzon imunitet; në rast se imuniteti nuk është hequr në përputhje me dispozitat e nenit XXII.

PJESA VI MARRËVESHJE SHITESË

Neni 25

Këshilli, duke vepruar në emër të organizatës, mund të përfundojë me cilindo Shtet Anëtar apo Shtete Anëtare marrëveshje shitesë që modifikojnë dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, për aq sa mund t'i interesojë atij shteti apo atyre shteteve.

PJESA VII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 26

1. Kjo Marrëveshje do të jetë e hapur për nënshkrim nga Shtetet Anëtare të organizatës dhe do t'i nënshtrohet ratifikimit. Instrumentet e ratifikimit do të depozitohen pranë Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila do të njoftojë të gjitha shtetet nënshkruese për çdo depozitim të tillë.

2. Sapo gjashtë vendet nënshkruese të kenë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në lidhje me ato shtete. Ajo do të hyjë në fuqi në lidhje me çdo shtet tjetër nënshkrues në datën e depozitimit të instrumentit të tij ratifikimit.

Neni 27

Kjo Marrëveshje mund të denoncohet nga cilido Shtet Kontraktues duke dhënë një njoftim me shkrim për këtë denoncim drejtuar Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila do të njoftojë të gjitha Shtetet nënshkruese për çdo njoftim të tillë. Denoncimi do të hyjë në fuqi një vit pas marrjes së njoftimit nga ana e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit e plotfuqishëm kanë nënshkruar këtë Marrëveshje. Bërë në Otava, më 20 shtator 1951, në gjuhët anglisht dhe frëngjisht, duke qenë të dy tekstet me të njëjtin autoritet, në një origjinal të vetëm, i cili do të depozitohet në arkivat e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila do t'i përcjellë një kopje të vërtetuar secilit nga shtetet nënshkruese.

LIGJ

Nr.10 103, datë 26.3.2009

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “MARRËVESHJEN PËR STATUSIN E MISIONEVE DHE TË PËRFAQËSUESVE TË SHTETEVE TË TRETA NË ORGANIZATËN E TRAKTATIT TË ATLANTIKUT TË VERIUT”

Në mbështetje të neneve 2 pika 3, 83 pika 1, 84 pika 4 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Marrëveshjen për statusin e misioneve dhe të përfaqësuesve të shteteve të treta në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut”, bërë në Bruksel më 14 shtator 1994.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MARRËVESHJE

MBI STATUSIN E MISIONEVE DHE PËRFAQËSUESVE TË SHTETEVE TË TRETA NË ORGANIZATËN E TRAKTATIT TË ATLANTIKUT TË VERIUT

Duke pasur parasysh Deklaratën mbi Paqen dhe Bashkëpunimin të bërë nga kryetarët e shteteve dhe qeverive që morën pjesë në takimin e Këshillit të Atlantikut të Veriut në Romë në datat 7 dhe 8 nëntor 1991 ku bëhej thirrje për ngritjen e një Këshilli për Bashkëpunimin e Atlantikut të Veriut si edhe Deklaratën e Këshillit për Bashkëpunimin e Atlantikut të Veriut mbi Dialogun, Partneritetin dhe Bashkëpunimin të datës 20 dhjetor 1991;

duke vërejtur ftesën për Partneritet për Paqe të lëshuar e të nënshkruar nga kryetarët e shteteve dhe qeverive të Shteteve anëtare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut në takimin e Këshillit të Atlantikut të Veriut të mbajtur në Bruksel më 10 janar 1994;

duke njohur nevojën për të përcaktuar statusin e misioneve dhe përfaqësuesve të shteteve të treta në Organizatë;

duke pasur parasysh se qëllimi i privilegjeve dhe imuniteteve që përmbahen në këtë Marrëveshje nuk është që të sjellë përfitime për individët por që të sigurojë kryerjen e efektshme të

funksioneve të tyre në lidhje me Organizatën;
palët në këtë Marrëveshje kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

Për qëllime të kësaj Marrëveshje:

“Organizata” nënkupton: Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut;

“Shtet anëtar” nënkupton: Një shtet anëtar në Traktatin e Atlantikut të Veriut të arritur në Uashington, më 4 prill 1949;

“Shtet i tretë” nënkupton: Një shtet i cili nuk është palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut të arritur në Uashington, më 4 prill 1949 dhe që ka pranuar ftesën për Partneritet për Paqe e ka nënshkruar Dokumentin Kuadër të Partneritetit për Paqe, është një shtet anëtar i Këshillit për Bashkëpunimin e Atlantikut të Veriut ose është çdo shtet tjetër i ftuar nga Këshilli i Atlantikut të Veriut për të vendosur një mision pranë Organizatës.

Neni 2

a) Shteti anëtar në territorin e të cilit ka selinë Organizata do t’i japë misioneve të shteteve të treta pranë Organizatës dhe anëtarëve të personelit të tyre, privilegjet dhe imunitetet që i janë dhënë misioneve diplomatike dhe personelit të tyre;

b) Për më tepër, shteti anëtar në territorin e të cilit ka selinë Organizata do t’i japë privilegjet dhe imunitetet tradicionale përfaqësuesve të shteteve të treta, me mision të përkohshëm, të cilët nuk mbulohen nga paragrafi (a) i këtij neni, ndërsa janë të pranishëm në territorin e tij, me qëllimin e sigurimit të përfaqësimit të shteteve të treta në lidhje me procedimet e Organizatës.

Neni 3

a) Kjo Marrëveshje do të jetë e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare dhe do t’i nënshtrohet ratifikimit, pranimi apo miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimi apo miratimit do të depozitohen pranë Qeverisë së Mbretërisë së Belgjikës e cila do të njoftojë të gjitha shtetet nënshkruese mbi depozitimin e çdo instrumenti të tillë;

b) Sapo dy ose më shumë shtete nënshkruese, duke përfshirë këtu shtetin anëtar në territorin e të cilit Organizata ka selinë e saj, të kenë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimi apo miratimit, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në lidhje me ato shtete. Ajo do të hyjë në fuqi në lidhje me secilin shtet tjetër nënshkrues në datën e depozitimit të instrumentit të tij.

Neni 4

a) Kjo Marrëveshje mund të denoncohet nga cilido shtet kontraktues duke dhënë një njoftim me shkrim mbi këtë denoncim tek Qeveria e Mbretërisë së Belgjikës e cila do të njoftojë të gjitha shtetet nënshkruese mbi çdo njoftim të tillë;

b) Denoncimi do të hyjë në fuqi një vit pas marrjes së njoftimit nga Qeveria e Mbretërisë së Belgjikës.

Në dëshmi të kësaj nënshkruesit, duke qenë të autorizuar siç duhet nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje tekstet e së cilës në anglisht dhe frëngjisht janë njëloj autentike.

Bërë në Bruksel, më 14 shtator 1994.

LIGJ

Nr.10 104, datë 26.3.2009

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “PROTOKOLLIN PËR STATUSIN

E SHTABEVE USHTARAKE NDËRKOMBËTARE, TË NGRITURA NË PËRPUTHJE ME TRAKTATIN E ATLANTIKUT TË VERIUT

Në mbështetje të neneve 2 pika 3, 83 pika 1, 84 pika 4 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Protokollin për statusin e shtabeve ushtarake ndërkombëtare, të ngritura në përputhje me Traktatin e Atlantikut të Veriut”, bërë në Londër më 19 qershor 1951.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PROTOKOLL

MBI STATUSIN E SHTABEVE USHTARAKE NDËRKOMBËTARE TË NGRITUR NË PËRPUTHJE ME TRAKTATIN E ATLANTIKUT TË VERIUT

Palët në Traktatin e Atlantikut të Veriut të nënshkruar në Uashington, më 4 prill 1949, duke marrë parasysh faktin se Shtabet Ushtarake Ndërkombëtare mund të ngrihen në territoret e tyre, me marrëveshje të veçanta, sipas Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe me dëshirën për të përcaktuar statusin e këtyre shtabeve dhe të personelit të tyre brenda zonës së Traktatit të Atlantikut të Veriut,

kanë rënë dakord me Protokollin aktual të Marrëveshjes, së nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, lidhur me Statusin e Forcave të tyre:

Neni 1

Në këtë Protokoll, shprehja

a) “Marrëveshja”, nënkupton marrëveshjen e nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, nga Palët e Traktatit të Atlantikut të Veriut për Statusin e Forcave të tyre;

b) “Shtabe supreme”, nënkupton Shtabin Suprem të Fuqive Aleate në Europë, Shtabin e Komandave Supreme të Aleatëve të Atlantikut dhe çdo shtab tjetër të barasvlershëm ndërkombëtar ushtarak të ngritur në përputhje me Traktatin e Atlantikut të Veriut.

c) “Shtabe aleate”, nënkupton çdo Shtab Suprem dhe çdo Shtab ushtarak ndërkombëtar të ngritur në përputhje me Traktatin e Atlantikut të Veriut, i cili varet drejtpërdrejt nga një Shtab Suprem.

d) “Këshilli i Atlantikut të Veriut”, nënkupton Këshillin e ngritur sipas nenit IX të Traktatit të Atlantikut të Veriut ose organet ndihmëse të autorizuar për të vepruar në emër të tij.

Neni 2

Sipas dispozitave të mëposhtme të këtij Protokolli, Marrëveshja do të jetë e zbatueshme për Shtabet Aleate në territorin e një pale të këtij Protokolli në zonën e Traktatit të Atlantikut të Veriut, si dhe për personelin civil dhe ushtarak të këtyre shtabeve dhe personave në ngarkim të tyre të përfshirë në përkufizimet e nënparagrafëve a, b dhe c, të paragrafit 1, të nenit III të këtij Protokolli, kur ky

personel është i pranishëm në këto territore në përputhje me detyrat e tyre zyrtare, ose kur janë persona në ngarkim, detyrat zyrtare të bashkëshortëve apo prindërve të tyre.

Neni 3

1. Për qëllim të zbatimit të Marrëveshjes për një Shtab Aleat, shprehjet “Forcë”; “Përbërës civil” dhe “Person në ngarkim”, sa herë që shfaqen në Marrëveshje do të kenë kuptimet e mëposhtme:

a) “Forcë”, nënkupton personelin e atashuar në Shtabin Aleat, i cili i përket forcave tokësore, detare apo ajrore të secilës nga Palët në Traktatin e Atlantikut të Veriut.

b) “Përbërës civil”, nënkupton personelin civil që nuk janë persona pa shtetësi e as shtetas të ndonjë shteti i cili nuk është Palë në Traktat, dhe që nuk janë me kombësi ose banorë të zakonshëm në Shtetin pritës dhe që janë (i) të atashuar në Shtabin Aleat dhe të punësuar në shërbimin ushtarak të ndonjëres nga Palët e Traktatit të Atlantikut të Veriut ose (ii) në kategori të tilla të personelit civil të punësuar në Shtabet Aleate siç do të vendosë Këshilli i Atlantikut të Veriut.

c) “Persona në ngarkim”, nënkupton bashkëshortin/en e një anëtarit të një force ose personelit civil, të përcaktuar në nën-paragrafin a dhe b, të këtij paragrafi ose fëmija që është në varësi të këtyre personave.

2. Një Shtab Aleat do të quhet si forcë për qëllimet e nenit II, paragrafit 2 të nenit V, paragrafit 10 të nenit VII, paragrafëve 2, 3, 4, 7 dhe 8 të nenit IX dhe nenit XIII të Marrëveshjes.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet që jep apo vendos Marrëveshja ndaj shtetit dërgues ose autoriteteve të tij për sa i përket forcave të saj ose përbërësve të tyre civilë ose personave në ngarkim, lidhur me një Shtab Aleat dhe personelin e tij dhe personat në ngarkim të tyre për të cilët zbatohet Marrëveshja në përputhje me nenin II të këtij Protokolli, do t’i kalohen ose bashkëngjiten Shtabeve Supreme përkatëse dhe autoriteteve përgjegjëse brenda tyre, përveç se:

a) e drejta e dhënë nga neni VII i Marrëveshjes ndaj autoriteteve ushtarake të shtetit dërgues për të ushtruar juridiksion penal dhe disiplinor do t’i kalohet autoriteteve ushtarake të Shtetit, në rast se ka, ligjit ushtarak të cilit i nënshtrohet personi i përfshirë.

b) detyrimet e ngarkuara shtetit dërgues apo autoriteteve të tij sipas nenit II, paragrafit 4 të nenit III, paragrafëve 5a dhe 6a të nenit VII, paragrafëve 9 dhe 10 të nenit VIII, si dhe nenit XIII të Marrëveshjes do t’i bashkëngjiten si Shtabit Aleat ashtu edhe secilit shtet shërbimi i armatosur të të cilit, ose çdo anëtar apo të punësuarit të shërbimit të armatosur të të cilit, apo personat në ngarkim të këtyre anëtarëve apo të punësuarve janë të përfshirë.

c) për qëllimet e paragrafit 2a dhe 5 të nenit III dhe nenit XIV të Marrëveshjes, shteti dërgues do të jetë, në rastin e anëtarëve të një force dhe personave në varësi të tyre, shteti, shërbimi i armatosur të të cilit i përket anëtarit, ose, në rastin e anëtarëve të një përbërësi civil dhe personat në varësi të tyre, shteti, nëse ka, nga shërbimi i armatosur i të cilit është punësuar anëtarit;

d) detyrimet e ngarkuara mbi shtetin dërgues sipas paragrafit 6 dhe 7 në nenin VIII të Marrëveshjes do t’i bashkëngjiten shtetit, shërbimi i armatosur të të cilit i përket personi, veprimi ose mosveprimi i të cilit ka dhënë shkak për ngritjen e pretendimit, ose në rastin e një anëtarit të një përbërësi civil dhe personave në varësi të tyre, shtetit në shërbimin e armatosur të të cilit ai është punësuar, ose kur nuk ka një shtet të tillë, Shtabit Aleat, anëtar i të cilit është personi në fjalë.

Si shteti, në rast se ka, të cilit i përkasin detyrimet sipas këtij paragrafi edhe Shtabi Aleat i përfshirë, do të kenë të drejtat e shtetit dërgues në lidhje me caktimin e një arbitri sipas paragrafit 8 të nenit VIII.

Neni 5

Çdo anëtar i një Shtabi Aleat do të këtë kartë identiteti personal të lëshuar nga Shtabi ku të jepet emri, data dhe vendlindja, kombësia grada, numri (nëse ka), fotografia dhe periudha e vlefshmërisë. Kjo kartë duhet paraqitur sipas kërkesës.

Neni 6

1. Detyrimet për të hequr dorë nga kërkesat mbi Palët Kontraktuese sipas nenit VIII të Marrëveshjes do t'i jepen si Shtabit Aleat edhe çdo pale të përfshirë në këtë Protokoll.

2. Për qëllimin e paragrafit 1 dhe 2 të nenit VIII të Marrëveshjes,

a) pronat e zotëruara nga një Shtab Aleat ose nga një palë e këtij Protokoll dhe të përdorura nga Shtabi Aleat do të quhen si prona në zotërim të një Pale Kontraktuese dhe të përdorura nga shërbimet e saj të armatosura.

b) dëmtimi i shkaktuar nga një anëtar i një force apo përbërësi civil siç përcaktohet në paragrafin 1 të nenit III të këtij Protokoll ose i shkaktuar nga persona të punësuar në Shtabin Aleat do të quhen si dëme të shkaktuara nga anëtarë ose të punësuar të shërbimeve të armatosura të Palës Kontraktuese

c) përkufizimi i shprehjes “në zotërim të Palës Kontraktuese” në paragrafin 3 të nenit VIII do të zbatohet lidhur me Shtabin Aleat.

3. Kërkesat për të cilat zbatohet paragrafi 5 i nenit VIII të Marrëveshjes do të përfshijnë pretendime (përveç kërkesave kontraktore dhe atyre që gjejnë zbatim në paragrafin 6 dhe 7 të atij neni) që rrjedhin nga veprime a mosveprime të punonjësve të Shtabit Aleat, ose që rrjedhin nga çdo veprim a mosveprim ose ngjarje të tjera për të cilat Shtabi Aleat është përgjegjës ligjërisht, të shkaktuara në territorin e një shteti pritës ndaj palëve të treta, të ndryshme nga çdo palë në këtë Protokoll.

Neni 7

1. Përfshirja nga taksat sipas nenit X të Marrëveshjes për anëtarët e një force ose përbërësi civil lidhur me pagat dhe shpërblimet e tyre do të zbatohet mbi personelin e Shtabit Aleat brenda përkufizimeve në paragrafin 1a dhe b (i) të nenit III të këtij Protokoll, për pagat dhe shpërblimet e paguara atyre si personel i tillë nga shërbimi i armatosur të cilit i takojnë ose nga i cili janë punësuar, përveçse ky paragraf nuk do të përjashtojë asnjë anëtar të tillë apo të punësuar nga taksat e vëna nga shteti nënshkruar i të cilit ai është.

2. Të punësuarit e një Shtabi Aleat sipas kategorive të miratuara nga Këshilli i Atlantikut të Veriut do të përjashtohen nga taksat mbi pagat dhe shpërblimet që u janë paguar nga Shtabi Aleat në cilësinë e tyre si të punësuar. Çdo palë e këtij Protokoll mund, sidoqoftë, të përfundojë një marrëveshje me Shtabin Aleat nga ku një palë e tillë do të punësojë dhe caktojë në Shtabin Aleat të gjithë shtetasit e vet (përveç, nëse pala kështu dëshiron, çdo person banues jo i përhershëm brenda territorit të tij) që do të shërbejnë në personelin e Shtabit Aleat dhe të paguajnë pagat dhe shpërblimet nga fondet e veta sipas një niveli të caktuar nga ajo vetë. Pagat dhe shpërblimet e paguara në këtë mënyrë mund të taksohen nga pala e interesuar por përjashtohen nga taksat e cilësdo palë tjetër. Në rast se një rregullim i tillë është bërë nga ndonjë palë në këtë Protokoll dhe më vonë është modifikuar ose përfunduar, Palët në Protokollin e tanishëm nuk do të jenë më të detyruara sipas fjalisë së parë të këtij paragrafi për të përjashtuar nga taksat pagat dhe shpërblimet që i paguhen shtetasve të tyre.

Neni 8

1. Me qëllim lehtësimin e ngritjes, ndërtimit, mirëmbajtjes dhe funksionimit të Shtabit Aleat, këto shtabe do të çlirohen në mënyrë sa më arsyeshme nga detyrimet dhe taksat, që ndikojnë në shpenzimet e tyre në interes të mbrojtjes së përbashkët dhe përfitimin e tyre zyrtar dhe ekskluziv, dhe çdo palë në këtë Protokoll do të hyjë në negociata me çdo Shtab Aleat që vepron në territorin e saj për të përfunduar një marrëveshje për t'i dhënë fuqi kësaj dispozite.

2. Një Shtab Aleat do të këtë të drejtat e dhëna një force sipas nenit XI të Marrëveshjes duke ju nënshtruar të njëjtave kushte.

3. Dispozitat e paragrafit 5 dhe 6 të nenit XI të Marrëveshjes nuk do të zbatohen për shtetasit e shtetit pritës në rast se këta shtetas nuk i takojnë shërbimeve të armatosura të një Pale të këtij Protokoll të ndryshme nga shteti pritës.

4. Shprehja “detyrime dhe taksa” në këtë nen nuk përfshin detyrimet për shërbimet e kryera.

Neni 9

Përveç kur Këshilli i Atlantikut të Veriut mund të vendosë ndryshe,

a) çdo pasuri e përfituar nga fondet ndërkombëtare të një Shtabi Aleat sipas buxhetit të tij dhe që nuk kërkohet më nga Shtabi do të disponohet sipas marrëveshjeve të miratuara nga Këshilli i Atlantikut të Veriut dhe të ardhurat do të shpërndahen midis ose do tu kreditohen palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut në masën në të cilën ata kanë kontribuar në kostot e kapitalit të Shtabit. Shteti pritës do të ketë të drejtën parësore për të përfituar çdo pronë të paluajtshme të disponuar në këtë mënyrë në territorin e tij me kusht që ai të ofrojë kushte jo më pak të favorshme se sa ato të ofruara nga cilado palë e tretë.

b) çdo sipërfaqe toke, ndërtesë apo instalime fikse të siguruar nga shteti pritës për përdorim të Shtabit Aleat pa pagesë (përveç ndonjë detyrimi nominal) dhe që nuk kërkohet më nga Shtabi do t'i kthehet shtetit pritës dhe çdo shtesë apo humbje në vlerën e pronës së siguruar nga shteti pritës si rrjedhim i përdorimit nga shtabi do të përcaktohet nga Këshilli i Atlantikut të Veriut (duke marrë parasysh çdo ligj të zbatueshëm të shtetit pritës) dhe shpërndahet ose kreditohet apo debitohet mes palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut në masën në të cilën ata kanë kontribuar ndaj kostove të kapitalit të shtabit.

Neni 10

Çdo Shtab Suprem ka personalitetin e tij juridik; ai do të ketë aftësinë për të përfunduar kontrata si dhe për të marrë dhe disponuar prona. Shteti pritës megjithatë mund t'ia nënshtrojë ushtrimin e aftësive të tilla rregullimeve të posaçme ndërmjet tij dhe Shtabit Suprem apo ndonjë Shtabi Aleat vartës që vepron në emër të Shtabit Suprem.

Neni 11

1. Sipas dispozitave të nenit VIII të Marrëveshjes, një Shtab Suprem mund të përfshihet në procedime ligjore si paditës ose i paditur. Megjithatë Shteti pritës dhe Shtabi Suprem apo ndonjë Shtab Aleat vartës i autorizuar prej tij, mund të bien dakord që shteti pritës do të veprojë në emër të Shtabit Suprem në çdo procedurë ligjore për të cilën ky shtab është palë përpara gjykatave të shtetit pritës.

2. Asnjë masë ekzekutimi apo masë e drejtuar për sekuestrimin ose ndalimin e pronave dhe fondeve të tij nuk do të merret ndaj cilitdo Shtab Aleat, përveçse për qëllimet e paragrafit 6a të nenit VII dhe nenit VIII të Marrëveshjes.

Neni 12

1. Për të mundësuar operimin e buxhetit të vet ndërkombëtar, një Shtab Aleat mund të mbajë valutë të çdo lloji dhe të kryejë llogaritë me çdo lloj valute.

2. Palët e këtij Protokolli, me kërkesën e Shtabit Aleat, do të lehtësojnë transferimin e fondeve të këtyre shtabeve nga njëri vend tek tjetri si dhe kthimin e çfarëdo valute të mbajtur nga një Shtab Aleat në çfarëdo valute tjetër kur paraqitet nevoja për të plotësuar kërkesat e Shtabit Aleat.

Neni 13

Arkivat dhe dokumentet e tjera zyrtare të një Shtabi Aleat të mbajtura në mjediset e përdorura nga ato Shtabe ose në zotërim të cilitdo personi të autorizuar në mënyrën e duhur nga Shtabet do të jenë të paprekshme përveç kur Shtabi ka hequr dorë nga ky imunitet. Shtabet, me kërkesë të shtetit pritës dhe në prani të një përfaqësuesi të atij shteti, do të verifikojnë natyrën e dokumenteve për të konfirmuar se ato kanë të drejtë të gëzojnë këtë imunitet sipas këtij neni

Neni 14

1. I gjithë ose cilado pjesë e këtij Protokoll ose e Marrëveshjes mund të zbatohet, me vendim të Këshillit të Atlantikut të Veriut, ndaj çdo shtabi ushtarak ndërkombëtar apo organizate (që nuk është e përfshirë në përkufizimet e paragrafit b) dhe c) të nenit I të këtij Protokoll) që është ngritur në përputhje me Traktatin e Atlantikut të Veriut.

2. Kur të jetë krijuar Bashkësia Europiane e Mbrojtjes, ky Protokoll mund të zbatohet për personelin e Forcave të Mbrojtjes Evropiane të atashuar në një Shtab Aleat, si dhe personave të tyre në ngarkim në kohën dhe mënyrën e përcaktuar nga Këshilli i Atlantikut të Veriut.

Neni 15

Të gjitha ndryshimet midis palëve në këtë Protokoll ose midis palëve dhe ndonjë Shtabi Aleat lidhur me interpretimin ose zbatimin e Protokollit do të zgjidhen përmes negociatave midis Palëve në mosmarrëveshje, pa iu drejtuar ndonjë juridiksioni të jashtëm. Përveçse aty ku dispozita përcakton të kundërtën në këtë Protokoll ose në Marrëveshje, ndryshimet të cilat nuk mund të zgjidhen me negociata të drejtpërdrejta do t'i referohen Këshillit të Atlantikut të Veriut.

Neni 16

1. Neni XV dhe nenet nga XVII deri XX të Marrëveshjes do të zbatohen lidhur me këtë Protokoll si të ishin një pjesë integrale e saj, por në mënyrë të tillë që Protokollin të mund të rishikohet, pezullohet, ratifikohet, miratohet, denoncohet ose shtyhet në përputhje me ato dispozita pavarësisht nga Marrëveshja.

2. Ky Protokoll mund të plotësohet me marrëveshje dypalëshe ndërmjet shtetit pritës dhe një Shtabi Suprem, dhe autoritetet e një Shteti pritës dhe Shtabit Suprem mund të bien dakord për t'i dhënë fuqi, me mjete administrative përpara ratifikimit, çdo dispozite të këtij Protokoll ose të Marrëveshjes siç zbatohet prej tij.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit e Plotfuqishëm kanë nënshkruar këtë Protokoll. Bërë në Paris, më 28 gusht 1952, në gjuhët anglisht dhe frëngjisht, duke qenë të dy tekstet me të njëjtin autoritet, në një origjinal të vetëm i cili do të depozitohet në arkivat e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës do t'ia përcjellë kopjet e vërtetuara të gjitha shteteve nënshkruese dhe atyre hyrëse.

URDHËR

Nr.92, datë 27.2.2009

PËR LICENCIMIN E AGJENCIVE TË ADMINISTRIMIT KOLEKTIV TË TË DREJTAVE TË PRODHUESVE SHQIPTARË TË FONOGRAMEVE DHE VIDEOGRAMEVE (AMI)

Duke marrë parasysh dokumentet e mëposhtme, bashkëlidhur:

1. Propozimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit, nr.25 prot., datë 13.1.2009 për licencimin e agjencisë “Ami” në fushën e fonogrameve dhe videogrameve;
2. Kërkesën dhe dosjen me dokumentacionin e agjencisë “Ami”,

konstatova se:

Në përmbushje të detyrimeve ligjore që burojnë nga ligji nr.9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, i ndryshuar, është kompetencë e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve miratimi i dhënies së licencës së kësaj agjencie.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 124 pika 1 të Kodit të Procedurave Administrative dhe të neneve 108 pika 1, 109 pika 2 dhe 3 të ligjit nr.9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Licencimin e Agjencisë së Administrimit Kolektiv të së Drejtës së Prodhuesve Shqiptarë të Fonogrameve dhe Videogrameve (AMI).
2. Afati i licencës është tre vjet nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.
3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
Ylli Pango



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE

LIÇENCË

Nr. 4 Dt. 27/02/2009

Në mbështetje të ligjit nr.9380, datë 28.04.2005 "Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me të" i ndryshuar, V.K.M nr 232 datë 19.04.2006 "Për krijimin dhe funksionimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit", Vendimi nr.343, datë 06.06.2007, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e tarifave për shërbimet, që ofron Zyra Shqiptare Për të Drejtat e Autorit" i ndryshuar, Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit konstatoi se dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kuadrin ligjor. Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,

VENDOSI:

Të licensojë

si Agjensi e Administrimit Kolektiv të të drejtave të lidhura me të drejtën e autorit të Prodhuesve të Muzikës (fonograme dhe videogrameve) Shqiptare.

Njohur si person juridik me Vendim të Gjykatës së Tiranës, me nr. 2439 datë 12.12.2008 Sella e ushtrimit të veprimtarisë: Rruga: "Andon Zako Çajupi", Nr.8, Tiranë, Shqipëri.

President : **Z. Agim HALILI**

Liçenca është e vlefshme për një periudhë 3 (tri) vjeçare
Liçenca duhet të ekspozohet në zyrat e agjensisë



Ami

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 26.3.2009
Doli nga shtypi më 26.3.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 36 lekë